

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI VJETOR
1994

Mars 1995

KAPITULLI I. Zhvillimet e ekonomise boterore dhe asaj kombetare.....	1
1. Prirjet e zhvillimit ekonomik boteror ne pergjithesi.....	1
2. Zhvillimi ekonomik-financiar ne Shqiperi.....	3
KAPITULLI II. Politika Monetare.....	8
1. Pavaresia e Bankes Qendrore.....	8
2. Politika Monetare e Bankes se Shqiperise.....	9
3. Zhvillimet e Agregateve Monetare dhe te Likujditetit.....	12
4. Politika e Interesave.....	16
5. Objektivat e Politikes Monetare per Vitin 1995.....	17
KAPITULLI III Sistemi Bankar.....	22
1. Struktura dhe Ristrukturimi i Sistemit Bankar.....	22
2. Mbikeqyrja dhe roli i saj ne Sistemin tone Bankar.....	23
KAPITULLI IV Krediti brendshem gjate vitit 1995.....	25
1. Krediti per Ekonomine.....	25
2. Situata e buxhetit te shtetit gjate vitit 1994.....	27
3. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij.....	28
KAPITULLI V Bilanci i Pagesave.....	30
1. Llogaria Korrente dhe Levizjet e Kapitalit gjate Vitit 1994.....	30
2. Importi i Kapitaleve.....	33
3. Zhvillimet ne Rezerven Valutore dhe Administrimi i saj.....	34
4. Tregu i Kembimeve Valutore.....	35
KAPITULLI VI Aktivitete te tjera.....	38
1. Administrimi i parase.....	38
2. Sistemi i kontrollit te brendshem.....	39
3. Administrimi i burimeve njerezore dhe kualifikimi.....	39
4. Zhvillimet ne Sistemin e Pagesave.....	41
5. Botimet periodike te Bankes se Shqiperise.....	42
6. Marrdheniet me Institucionet Financiare Nderkombetare.....	43
7. Informatizimi ne Sistemin Bankar.....	44

KAPITULLI I. ZHVILLIMET E EKONOMISE BOTERORE DHE ASAJ KOMBETARE

1. Prirjet e zhvillimit ekonomik boteror ne pergjithesi

Viti 1994 mund te quhet si viti i parashikimeve pergjithesisht te gabuara per nje dollar te qendrueshem, obligacione te fuqishme dhe nje ekonomi gjermane ne renie. Megjithate, prodhimi i pergjithshem boteror, ne perputhje dhe me parashikimet e bera, vleresohet te jete rritur me 3.8 perqind, nderkohe qe inflacioni vetem ne vendet e industrializuara ishte dicka me pak se 2.5 per qind. Gjate vitit te kaluar rritje te madhe pesoi volumi tregtise boterore me 9 per qind me shume se nje vit me pare.


Perjashtuar ish-republikat e Bashkimit Sovjetik, viti 1994 mund te konsiderohet i sukseshem per ekonomite e Evropes Lindore dhe Qendrore. Ndalja e renies se metejshme te prodhimit, perpjekjet per te vene nen kontroll inflacionin, pershpjtimi i privatizimit dhe reforma te tjera strukturore, ishin aspektet pozitive te shteteve te tilla, si Ceki, Hungari, Poloni, Rumani, Republikat Balltike, etj.

Viti 1994, ishte nje nga vitet me te mira per ekonomine **Amerikane** te pasluftes, me nje rritje prodhimi prej 4 per qind dhe nje perqindje mesatare inflacioni 2.7 per qind. Kapacitetet prodhuese u shfrytezuan ne masen 85.4 per qind (me i larti qe prej 1979), ndera numri i vendeve te reja punes ishte 3.5 milione. Politika fiskale e administrates se Klintonit, rezultoi pergjithesisht e suksesshme. Vendorsja e kontrollit mbi shpenzimet si dhe te ardhurat shume me te larta nga c'ishin parashikuar mundesuan uljen e deficitit nga 4 ne 3 per qind te prodhimit te pergjithshem. Deficiti tregtar ne tremujorin e fundit arriti ne afersisht 40 miliarde dollare, duke perkeqesuar me tej deficitin e llogarise korrente per 1994, qe mendohet te perbeje problemin baze per ecurine e monedhes amerikane gjate 1995.

Ne parashikimet per 1995, pritet te ndihen pasojat e pershpjtimet te rritjes ekonomike, te politikes liberale te ndjekur nga Federal Reserve ne vitet 1992 dhe 1993, te uljes se perqindjes se papunesise, te shfrytezimit te larte te kapaciteteve prodhuese si dhe te zhvleresimit te ndjeshem te dollarit amerikan, etj. Te gjitha keto zhvillime sugjerojne nje ngritje ciklike te inflacionit prej rreth 3.5 per qind ne vitin 1995.

Ekonomia **Japoneze** u rrit me ngadalesi, vetem 0.7 per qind kete vit. Prodhimi industrial, krahasuar me nje vit me pare u rrit me 0.8 per qind. Ne vjeshten e vitit 1994, pas nje faze te shkurter inflacioni negativ, cmimet e konsumit filluan te rriten gradualisht. Si rezultat i rritjes se ekonomise nen

potencialin e saj afatgjate dhe te rritjes shume te moderuar te ofertes monetare, nuk pritet rritje ne perqindjen e inflacionit ne te ardhmen e afert.




Ne **Gjermani**, prodhimi i pergjithshem eshte rritur 2.8 per qind. Rritja kryesisht erdhi nga rritja vjetore e volumit te eksportit qe mundesoi rritjen e prodhimit industrial 3.5 per qind ne fund te 1994. Veprimi afatgjate i Bankes Qendrore Gjermane, ne nje shkalle te madhe si ne Gjermani edhe jashte saj, edhe per kete vit ishte nje nga faktoret percaktues mbeshtetes te markes gjermane. Nder faktoret e tjere permendim: zhvillimi pozitiv i ekonomise, ulja e perqindjes se inflacionit, niveli i larte i perqindjes reale te interesit si dhe rritja e madhe e kerkeses per kapital te huaj investues.

Zbatimi i nje politike monetare te shtrenguar gjate vitit 1995 (rritja e ofertes monetare ne kufijte 4-6 per qind), do te sherbeje si mase mbrojtese kundrejt ndonje ngritje te mundshme te inflacionit ne 1996.

Ne **Itali**, per shkak te situates se turbullt politike te ketij vendi, lireta dhe vlera e obligacioneve afatgjate italiane pesuan renie te forta ne fund te vitit te kaluar. Inflacioni pas nje renie te ndjeshme ne muajt e pare te vitit 1994, perseri u pershpjetua ne fund te vitit duke u ngritur ne nivelin 3.8 per qind. Megjithate, rritja prej 6.1 per qind e prodhimit industrial ndikoi fuqishem ne rritjen e prodhimit te pergjithshem, i cili u rrit me 2 per qind. Pati nje permiresim shume te lehte te bilancit fiskal te Qeverise i cili nga 10.5 te GDP-se ne 1993 arriti ne 9.7 perqind ne fund te vitit 1994.

Megjithate sukseset e arritura ne ndaljen e renies se metejshme te prodhimit, ekonomite ne tranzicion vazhdojne te ballafaqohen me nje norme relativisht te larte inflacioni. Pavaresisht nga perpjekjet e bera inflacioni vazhdon te jete i pameshirshem me Rusine dhe shume nga ish-republikat sovjetike, dhe nga ana tjetere vazhdon te shqetesojte shtete te tilla si Bullgaria, Hungaria, Polonia, Republikat Balltike, etj.



Ne **Rusi** cmimet e konsumit vazh-duan perseri rritjen e tyre me tre shifra krahasuar me nje vit me pare (inflacioni vjetor 227 per qind ne fund te vitit). I tere deficitit buxhetor i vitit te kaluar u mbulua me kredi nga banka qendrore dhe nga ana tjetere, deri ne fund te vitit Rusia nuk ndermori asnje veprim konkret per ndonje shtrengim te mundshem ne politiken kredituese ne pergjithesi. Pozicioni i jashtem i vendit u perkeqesua akoma me shume. Ne fund te vitit rezervat valutore shenonin 2 miliarde dollare, ose vetem 0.7 muaj import nga 2.4 nje vit me pare. Ky shterim i rezervave u shoqerua me nje zhvleresim drastik te rubles, e cila ne fund te vitit shenonte raportin 3550 rubla per nje dollar nga 1247 qe ishte ne fund te vitit te meparshem.

2. Zhvillimi ekonomik-financiar ne Shqiperi.

Viti i dyte i programit afatmesem u karakterizua ne pergjithesi nga nje ecuri relativisht e suksesshme e ekonomise shqiptare. Objektivat finale makroekonomike u realizuan ne menyre te kenaqshme: rritja e prodhimit te pergjithshem te brendshem vleresohet te jete rreth 7.4 per qind nga 8 per qind si objektivi dhe perqindja vjetore e inflacionit u ul ne nivelin 15.8 per qind nga 24 per qind e parashikuar. Ringjallja e ekonomise u shoqerua me rritje te investimeve, te cilat midis te tjerash ndikuan ne zbutjen e papunesise. Investimet gjithsej llogariten rreth 16 per qind te prodhimit te pergjithshem nga 14 per qind nje vit me pare, ndersa papunesia u luhet ne rreth 18 per qind te fuqise se punes¹.

Arritja e objektive kryesore eshte realizuar nepermjet vendosjes nen kontroll te kerkeses se brendshme dhe permiresimit te pozicionit te jashtem te vendit. Zbatimi i nje politike monetare dhe fiskale te shtrenguar ishin dhe mbeten dy nga shtyllat kryesore qe bene te mundur vendosjen e

¹Numri i te papuneve ne fund te 1994 ishte gjithsej 261 mije persona.

kontrollit mbi kërkesen e brendshme. Ne fund te 1994, kërkesa e brendshme gjithsej llogaritej ne 131 per qind te prodhimit te pergjithshem, nderkohe qe nje vit me pare ishte dicka me shume se 150 per qind e prodhimit.

Si pasoje e politikave fiskale te studjuara dhe efektive, deficiti buxhetor ne raport me prodhimin e pergjithshem u ul ne nivelin 7.8 per qind nga 10.3 per qind qe ishte vitin e kaluar. Ne strukturen e te ardhurave u evidentua nje zbehje e te ardhurave nga ndihmat dhe nje rritje te peshes se te ardhurave nga sistemi i tatimeve dhe taksave.

Prioriteti i Bankes se Shqiperise, edhe gjate vitit 1994, mbeti zbatimi i nje politike monetare te shtrenguar, per te ruajtur kontrollin e vendosur mbi oferten e parase dhe ne kete menyre stabilitetin e cmimeve.

Deficiti i llogarise korrente² krahasuar me vitin 1993 u permiresua me 28 milione dollare duke arritur 240 milione dollare (13.4 per qind e prodhimit te pergjithshem). Shkaku kryesor i ketij permiresimi ishte nje deficit tregtar rreth 30 milione dollare me i ulet se nje vit me pare. Zhvillimet ne pozicionin e jashtem te vendit nuk sollen ndonje ndikim ne kursin e kembimit te lekut me monedhat e huaja. Pergjithesisht gjate vitit 1994, leku qendroi i forte kundrejt dollarit amerikan, markes gjermane, dhrahmises greke dhe liretes italiane.

Ashtu si dhe gjate vitit 1993, rritja e prodhimit te pergjithshem u sigurua kryesisht ne dege te tilla si bujqesi, transport, ndertim dhe sherbimet.

Bujqesia shenoi nje rritje prej rreth 7 per qind krahasuar me vitin 1993, duke siguruar rreth 56 per qind te prodhimit material neto. Nga vleresimet me te fundit eshte rritur siperfaqja e mbjelle e prodhimit bujqesor si dhe numri e prodhimi i blegtorise. Siperfaqja e mbjelle me grure dhe foragjere, u rrit respektivisht 20 dhe 12 per qind. Prodhimi i grurit vleresohet te jete rritur me 9 per qind, i perimeve 1 per qind, i frutave me 7 per qind etj. Nderkohe kane pesuar renie prodhimi i misrit, i fasules dhe i patates. Edhe kete vit, prodhimi i bimeve industriale mbeti ne kuota te uleta.

Ndertimi u rrit me rreth 15 per qind, duke zene rreth 10 per qind te prodhimit material neto. Prioritet ka marre ndertimi i apartamenteve te banimit si nga Enti i Banesave ashtu dhe nga individet. Rritja e ndjeshme e importit te cimentos ka kompensuar ate renie te vogel qe pesoi prodhimi i brendshem, duke mundesuar rritjen e kesaj dege.

²Perjashtuar transfertat shteterore.

Rritja vjetore e Prodhimit ne perqindje sipas degeve

Deget	1990	1991	1992	1993	1994	1995*
Industria	-19.6	-36.9	-60.0	-10.0	-2.0	2.0
Bujqesia	-4.4	-20.9	18.0	14.4	6.8	6.5
Ndertimi	-14.6	-30.4	5.0	31.5	15.0	7.0
Transporti	-15.9	-29.9	-20.0	13.0	18.0	5.0
Sherbimet	-16.4	-13.9	5.0	11.5	11.0	7.0
GDP		-27.7	-9.7	11.0	7.4	6.0



*parashikim


Transporti u rrit me 18 per qind, duke zene rreth 3 per qind te prodhimit material neto. Se bashku me ndertimin, transportin eshte dega qe pati zhvillimin me te madh dhe ku sektori privat luajti rol te rendesishem. Sipas shifrave te fundit te vitit ne transportin e mallrave krahasuar me vitin 1993, ka rnie te peshes specifike te transportit automobilistik dhe gjallerim te transportit hekurudhor.

Rritje te ndjeshme ka ne transportin e pasagjereve dhe te mallrave nepermjet ajrit, ku sot operojne me se 10 shoqeri fluturimi.

Po keshtu **sherbimet** jane rritur me rreth 11 per qind, duke perbere rreth 19 per qind te prodhimit material neto. Ndoshta, tani per tani, sherbimet perbejne degen ku efektiviteti i sektorit privat eshte me i dukshmi.

Industria eshte e vetnja dege, prodhimi i se ciles shenoi perseri rnie gjate vitit 1994. Keshtu, prodhimi ne kete dege, ne krahasim me vitin 1993, vleresohet te kete rnie me 2 per qind duke sjelle rnie te metejshme te peshes specifike te kesaj dege ne produktin material neto te realizuar gjate vitit 1994.





KAPITULLI II. POLITIKA MONETARE

1. Pavaresia e Bankes Qendrore

Ne nje ekonomi tregu, ndryshe nga ekonomia e centralizuar, qeveria nuk mund te jete me pergjegjese per stabilitetin e cmimeve. Pikerisht per kete arsye krijohet nje autoritet monetar per te kontrolluar oferten e parase dhe keshtu edhe inflacionin. Autoriteti monetar, ose banka qendrore mund te jete e suksesshme ne ruajtjen e stabilitetit te cmimeve vetem nese ka autonomi ne marredheniet me qeverine, parlamentin dhe organet ligjore.

Aspektet me te rendesishme te pavaresise se bankes qendore konsistojne ne pavaresine personale, funksionale dhe financiare, te cilat parashikohen edhe ne Ligjin "Per Banken e Shqiperise".

Ligji nr.7559, date 22.4.1992 "Per Banken e Shqiperise", sanksionon se objektivi primar i Bankes se Shqiperise do te jete ruajtja e vleres se brendshme e te jashtme te monedhes kombetare nepermjet zbatimit te nje politike monetare te pershtatshme si dhe siguron premiset e nevojshme per nje pavaresi relative te saj. Ne kete ligj percaktohen edhe kriteret ligjore te pavaresise qe konsistojne kryesisht ne faktin qe asnje organ shteteror nuk mund t'i jape direktiva Bankes se Shqiperise, te marre vendime ne emer te saj, apo te anuloje ndonje vendim te saj.

Menyra e zgjedhjes dhe kohezgjatja e mandatit te organeve te Bankes se Shqiperise qe parashikohen ne ligj jane pa dyshim elemente thelbesore te pavaresise se saj. Fakti qe Guvernatori i Bankes se Shqiperise emerohet nga Presidenti i Republikes per nje periudhe 6 vjecare rrit autonomine Bankes nga qeveria. Po ashtu, tre nga kater anetaret e jashtem te Keshillit Mbikeqyres te Bankes emerohen nga Presidenti i Republikes.

Persa i perket pavaresise funksionale, Banka e Shqiperise eshte insitucioni i vetem qe ka kompetenca ne:

- hartimin dhe zbatimin e politikës monetare ne funksion te objektivave finale;
- emetimin e monedhes se vendit
- percaktimin e rregjimit te kembimeve valutore.

Banka e Shqiperise eshte e lire si ne zgjedhjen e objektivave te politikës monetare ashtu edhe ne zgjedhjen e instrumentave te kesaj politike. Nderkohe, Banka e Shqiperise keshillohet me institucionet e tjera qendrore dhe vecanerisht me

Ministrine e Financave per ceshtje makroekonomike te rendesise se vecante dhe te interesit te perbashket, qe natyrisht perfshijne dhe politiken monetare.

Pavaresia financiare, e cila nenkupton nga njera ane financimin e deficitit buxhetor nga banka qendrore dhe nga ana tjeter ceshtjen e burimeve te veta financiare dhe menyren e ndarjes se fitimit te bankes, merr nje rendesi kritike per momentin. Sipas ligjit "Per Banken e Shqiperise" Banka e Shqiperise mund te financoje me kredi te drejtperdrejte deficitin buxhetor te vitit korrent deri ne 10 per qind te te ardhurave te buxhetit te shtetit per vitin e kaluar. Ky kufizim i krijon Bankes se Shqiperise mundesine per te kontrolluar Bazen Monetare, Oferten e Parase po keshtu edhe inflacionin. Sidoqofte, ne kushtet kur publiku (perfshire bankat tregtare) nuk ka qene i interesuar t'i huaje qeverise me interesa me te uleta se te tregut, qeveria i eshte drejtuar bankes qendrore per financim duke u bere keshtu shkak per nje mbi oferte te bazes monetare. Nga ana tjeter procedura e ndarjes se fitimit ne Ligjin "Per Banken e Shqiperise" krijon premisat e nevojshme si per kryerjen e shpenzimeve te domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit te saj ashtu edhe per rritjen e fondeve te veta.

Sidoqofte pavaresia e Bankes Qendrore pervec te drejtave nenkupton edhe detyrime. Banka e Shqiperise pergjigjet per veprimtarine e saj perpara Kuvendit Popullor dhe ne intervale 6-mujore i dorezon Keshillit te Ministrave nje deklarate per politiken monetare, ne te cilen permbahen:

- a) vleresimin i politikës monetare te zbatuar nga Banka e Shqiperise per periudhen e meparshme;
- b) politika monetare qe do te ndiqet gjate gjashte muajve te ardhshem;
- c) parimet per hartimin dhe zbatimin e politikës monetare per nje periudhe qe cakton Banka e Shqiperise.

2. Politika Monetare e Bankes se Shqiperise

Objektivi kryesor i politikës monetare te Bankes se Shqiperise eshte stabiliteti i cmimeve. Megjithate, Banka e Shqiperise ne vendosjen dhe realizimin e objektivit kryesor ka parasysh edhe nje sere synimesh te tjera si perkrahja e rritjes se prodhimit dhe vendosja e ekuilibrit ne sektorin e jashtem te ekonomise etj., qe ne sinteze permblidhen ne ruajtjen e stabilitetit makroekonomik te vendit. Politika monetare e Bankes se Shqiperise mund te konsiderohet si nje politike relativisht e shtrenguar ne parandalimin e rritjes se presioneve inflacioniste te kerkeses se brendshme, qe do ta shtynin ekonomine ne cbalancime.

Programi monetar i Bankes se Shqiperise synon te siguroje nje ekspansion te tille monetar, qe nepermjet nje konsumi te moderuar, te nxise rritjen e prodhimit drejt

nivelit të tij potencial (kapacitetit të plotë) duke ruajtur një nivel të pranueshëm inflacioni. Në funksion të këtyre objektivave janë caktuar kufijtë e rritjes së masës monetare, për kontrollin e së cilës Banka e Shqipërisë është mbështetur kryesisht në instrumentin e drejtpërdrejtë kufi krediti.

Banka e Shqipërisë në realizimin e objektivave të saj, ka ndjekur dy drejtime të kontrollit monetar:

Drejtimi i parë është ai i kontrollit të ofertës së bazës monetare dhe është realizuar nëpërmjet

- objektivave për mjetet e huaja neto
- kufirin të kredisë për qeverinë (instrument direkt) dhe
- një politike të matur në kreditimin e bankave të nivelit të dytë (rifinancimi)

Drejtimi i dytë është ai i kontrollit të ekspansionit, ose shumezimit të kësaj baze monetare në masën monetare (parane gjithsej). Për këtë Banka e Shqipërisë është mbështetur kryesisht në instrumentin direkt kufi krediti, por edhe në instrumenta indirekte si rezervat e detyrueshme, normat e interesit etj.

Mjetet e Huaja Neto - Në vitin 1992 Banka e Shqipërisë kaloi nga kursi fiksis i këmbimit në regjimin fleksibel të këmbimeve valutore. Argumenti bazë i kësaj strategjie ishte siguri i ekuilibrit të sektorit të jashtëm të ekonomisë përmes lëvizjes së lire të kursit të këmbimit në tregun valutë. Gjithashtu, adoptimi i këtij sistemi lidhet edhe me dy arsye të tjera:

- Banka e Shqipërisë trashëgoi një borxh të jashtëm relativisht të lartë dhe rezerva të pakta valutore, me të cilat nderhyrjet në treg do të ishin të pamundura
- Një sistem i tillë do t'i krijonte Bankës së Shqipërisë mundësinë për t'u përqendruar më shumë në zhvillimet e sektorit të brendshëm të ekonomisë.

Kreditimi për Qeverinë - Në kuadrin e programimit financiar, për të kontrolluar rritjen e parase gjithsej, kufiri i përgjithshëm i kreditit të brendshëm detajohet në kufi kredie për qeverinë dhe për ekonominë. Megjithatë kredia e drejtpërdrejtë është përmbajtur kufijve të programit, ajo është pasuar nga fenomene negative: jo aq në aspektin e rritjes së parase gjithsej, apo në zhvillimet ekonomike të vendit sa në aspektin e ekspansionit të bazës monetare. Për vitin 1994 Banka e Shqipërisë financoi drejtpërdrejt me kredi 91.1 për qind të deficitit buxhetor. Në prezencën e kufijve të kreditit, ky financim i buxhetit me kredi të drejtpërdrejtë nga Banka e Shqipërisë ka krijuar një mbi-ritje të bazës monetare dhe konkretisht të likuiditeteve të tepërta të sistemit bankar, rritje e cila tejkalon kërkesën e ekonomisë për para

rezerve (baze monetare). Nje zhvillim pozitiv ne drejtim te uljes se ketij kreditimi ishte financimi per here te pare i nje pjese te deficitit buxhetor jashte bankes qendrore, ose financim jo monetar i deficitit buxhetor, i cili u realizua ne tregun e Bonove te Thesarit ne Banken e Shqiperise. Megjithate, financimi i deficitit permes emetimit te letrave me vlere mbetet ende mjaft i ulet (rreth 7per qind e deficitit). Kredia nga Banka e Shqiperise per mbulimin e deficitit buxhetor, qe ne fund te dhjetorit te vitit 1994 ishte pothuaj sa dyfishi i bazes monetare, mbetet percaktuesja kryesore e zhvillimeve te bazes monetare.

Reformat e sektorit financiar ne Shqiperi synojne ne nje shperndarje me te mire te burimeve financiare kryesisht permes instrumentave dhe sinjaleve te tregut. Pikerisht, liberalizimi i interesave, pavaresia e bankes qendrore dhe nje sistem financiar me konkurrues, jane momentet kryesore te nje sistemi te liberalizuar financiar, drejt te cilit synohet. Nga ana tjeter, keto momente kyce te reformes, e sidomos politika me efektive e interesave per te kaluar drejt percaktimit te tyre ne treg, jane edhe bartesit kryesore te kontradiktave mes borxhit publik dhe objektivave te politikës monetare. Politika e administrimit te borxhit publik duke synuar ne shpenzime te uleta interesash, preferon financimin me kredi direkte nga Banka e Shqiperise, i cili eshte me pasoja negative per reformat e sistemit financiar. Ne kete kontekst, koordinimi dypalesh, merr nje rendesi te vecante sidomos ne momentin e kalimit ne fazen e krijimit dhe zhvillimit te tregut primar te letrave me vlere te qeverise, i cili duhet te misheroje si objektivat e politikës se borxhit publik ashtu edhe ato te politikës monetare.

Ne kete kuader, Banka e Shqiperise per vitin 1995 do te financoje deficitin buxhetor deri ne nivelin e realizimit te objektivave te bazes monetare dhe kundrejt sigurimit te kesaj kredie me letra me vlere te tregtueshme. Perverc realizimit te objektivave ne fushen monetare, kjo do te ndihmoje ne ngushtimin e hapesires midis pavaresise ligjore dhe asaj praktike te Bankes se Shqiperise.

Rifinancimi - Kreditimi i bankave te nivelit te dyte, ose rifinancimi ka vazhduar te perdoret si nje instrument me qellim te dyfishte. Nga nje ane, ka sherbyer per te siguruar likuiditete per bankat dhe per te mbajtur nen kontroll tregun nderbankar, nga ana tjeter duke qene nje kredi e shtrenjte ka sherbyer si nje instrument penalizues. Ne kete menyre mbi bankat eshte ushtruar presion financiar per t'i detyruar ato te rigjallerojne burimet e tyre te likuiditetit dhe te permiresojne ne pergjithesi situaten financiare. Kostoja dhe madhesia e rifinancimit eshte percaktuar nga Banka e Shqiperise mbi baze te politikës dhe zhvillimeve monetare. Megjithate prirja kryesore e Bankes se Shqiperise ka qene inkurajimi i tregut nderbankar, i cili jo vetem nuk fryn bazen monetare, por edhe zhvillon sistemin financiar ne pergjithesi.

Kufiri i Kreditit - Qe ne fillimet e saj, per zbatimin e politikes monetare Banka e Shqiperise eshte bazuar kryesisht ne instrumentat direkte, por duke mbajtur parasysh dhe punuar njekohesisht per futjen dhe rritjen e veprimit dhe te efektivitetit te instrumentave indirekte. Gjate viteve '89-'92, ne kushtet e nje inflacioni galopant si pasoje e deficitit buxhetor jashte cdo kufizimi, per te rivendosur me shpejtesi kontrollin monetar vendosja e kufijve te kreditit per financimin e deficitit buxhetor si edhe per ekspansionin monetar te bankave te nivelit te dyte per ekonomine ishte me se e domosdoshme. Me fillimin e rivendosjes se kontrollit mbi zhvillimet monetare, per te evituar krijimin e hapësirave te teperta dhe te paperdorura ne kufirin e kreditit dhe per te stimuluar dhe krijuar kushte per nje sistem bankar konkurrues, Banka e Shqiperise beri edhe me efektiv kete instrument duke lejuar tregtueshmerine e kufirit te kredise midis bankave te nivelit te dyte.

Rezervat e Detyrueshme - Ne fazen aktuale te zhvillimit, vendosja e rezervave te detyrueshme sherben si nje mbeshtetje per detyrimet ne forme depozitash te bankave tregtare, si mjet per te thithur pjeserisht likuiditetin e tepert te sistemit bankar, si nje burim te ardhurash per banken qendrore dhe si nje parapergatitje per kalimin nga instrumentat direkte ne instrumentat indirekte te politikës monetare. Rrjedhimisht, rezerva e detyrueshme mund te behet nje instrument aktiv i politikës monetare vetem pas heqjes se kufijve te kreditit dhe adoptimit te instrumentave indirekte te politikës monetare. Perdorimi i ketij instrumenti te kontrollit te terthorte te shumezimit te parase ka ardhur duke u permiresuar vazhdimisht me procedura te reja transparente dhe jodiskriminuese, duke ndikuar ne kete menyre mbi likuiditetin e bankave, per pasoje edhe ne potencialin e tyre per te kredituar.


Normat e Interesit - Ne perputhje me ambjentin ekonomik, si edhe duke marre ne konsiderate mungesen e nje tregu te zhvilluar te kapitaleve dhe letrave me vlere ne Shqiperi, Banka e Shqiperise ka perdorur kontrollin e drejtperdrejte mbi nivelin e interesave. Megjithate synimi i saj ka qene t'i jepet elasticitet ketij instrumenti ne treg permes kombinimit te interesave te rfinansimit dhe interesave per depozitat, duke lene te lire nivelin e interesit per aktivitetin kredidhenes. Kjo ka synuar mbajtjen ne nivele pozitive te interesave reale dhe pershtatjen e tyre sipas ecurise se nivelit te inflacionit. Nderkohe, eshte mbajtur parasysh qe nga njera ane niveli i larte i interesave nuk nxit dhe nuk inkurajon investimet dhe prodhimin dhe ka efekte frenuese e perkeqesuese per ekonomine dhe sistemin financiar, dhe nga ana tjeter nje nivel i ulet interesash nuk mund te siguroje kursimet e mjaftueshme ne ekonomi te cilat te mund te perdoren per te siguruar investime te qendrueshme ne periudha afatmesme dhe afatgjata.

3. Zhvillimet e Agregateve Monetare dhe te Likuiditetit

Objektivi primar i politikës monetare ishte ulja e inflacionit vjetor ne 24 per qind ne dhjetor te vitit 1994. Ne programin monetar parashikohej nje objektivi i ndermjetem per rritjen e parase gjithsej prej 29 per qind ne perputhje me rritjen e vleresuar potenciale te ekonomise (8 per qind) dhe me objektivin per inflacionin.


Me nje inflacion vjetor 15.8 per qind ne fund te dhjetorit 1994 (4 pike me i ulet se objektivi i programuar), politika monetare e vitit 1994 mund te konsiderohet e suksesshme. Njekohesisht, pozitiv eshte fakti qe pergjysmimi i normes se inflacionit te vitit 1993 (mbi 30 per qind) nuk frenoi zhvillimin ekonomik te vendit. Perkundrazi, rritja reale ekonomike rezultoi mjaft afer perqindjes se vleresuar potenciale te rritjes.

Pas nje rritjeje 74.4 per qind gjate vitit 1993, rritja e Parase Gjithsej gjate ketij viti,



ngadalesohet ne 38.7 per qind. Gjithsesi i thyerja e obje-ktivit nuk u shoqerua me presione inflacioniste sepse publiku absorboi kete rritje duke mbajtur

me shume para ne krahasim me te ardhurat, qe u shfaq ne nje shpejtësi te qarkullimit te parase 0.33 njesi me te ulet se ajo e programuar. Gjate tre tremujoreve te pare te vitit Paraja Gjithsej ruan te njejten ecuri me vitin e kaluar, ndersa ne tremujorin e




katert ritmi i rritjes rritet se tepermi per shkak te nje kerkese shume me te larte per financim te buxhetit. Ky pershejtim reflektohet edhe ne uljen e ndjeshme te shpej-

tesise se qar-kullimit te parase ne tremujorin e fundit.

Krediti i Brendshem pati ndikimin kryesor ne rritjen e Parase Gjithsej me rreth 27 njesi perqindje, ne te cilin peshen me te madhe e mban financimi i deficitit buxhetor (20 njesi perqindje). Kredia per Ekonomine, rreth 90 per qind e se ciles dhene sektorit privat, ka kontribuar vetem me 6 njesi perqindje ne rritjen e Parase Gjithsej. Gjithashtu, burimet me te larta valutore te sistemit bankar plus blerjet e konsiderueshme ne tregun valutor permiresuan Mjetet Valutore Neto duke ndikuar ne menyre modeste ne rritjen e parase me afro 9 njesi perqindje.


Pjesa me e madhe e shteses se parase gjithsej mori formen e rritjes se depozitave me



rreth 20 njesi perqindje³ edhe pse hapi i rritjes se tyre ishte me i ulet se ai i rritjes se parase jashte bankave. Nivelet pozitive te interesave reale dhe stabiliteti i lekut ne tregun e bre-

ndshem ishin faktoret kryesore te rritjes me te shpejte te depozitave me afat (agregatit monetar M2) ne krahasim me depozitat pa afat dhe ato ne valute (perkatesisht agregatet M1 dhe M3).

Procesi i shpejte i privatizimit, rriti mjaft depozitat e sektorit privat dhe te individeve (rreth 62 per qind) ne krahasim me vitin e kaluar duke zvogeluar akoma dhe me shume peshen e depozitave te ndermarrjeve shteterore.



Gjate vitit 1994 kerkesa e publikut per kartmonedhe ne krahasim me depozitat u rrit dukshem.


Shtimi i numrit te firmave te vogla e te mesme tregtare

apo prodhuese, te cilat kane nje perdorim relativisht te ulet te sherbimeve bankare, si

³ nga 39 per qind e rritjes se parase gjithsej

dhe ndergjegjesimi i publikut per nje prirje te qendrueshme ne renie te inflacionit, vleresohen te jene faktoret kryesore te kesaj preference. Ndikim negativ ka patur edhe nje sistem pagesash dhe sherbimesh bankare akoma jo-efektive.

Financimi i pjeses dermuese te deficitit buxhetor me kredi te drejtperdrejte nga Banka e Shqiperise dhe kontrolli monetar i bazuar kryesisht ne kufijte e kreditit, jane faktoret kryesore te nje niveli te larte te rezervave te teperta te bankave tregtare. Ne dhjetor te vitit 1994 likujditetet e teperta te sistemit bankar rezultojne sa nje e pesta e bazes monetare, fraksion ky mjaft i larte. Megjithese ne nje nivel te larte, likujditetet e teperta kane nje prirje te lehte ne renie gjate vitit. Kjo eshte edhe arsyeja e rritjes se shumezuesit te parase me 0.22 pike nga dhjetori 1993 (1.60) ne tetor 1994 (1.82). Rritja intensive e deficitit buxhetor ne tre muajt e fundit te vitit bymeu perseri rezervat e teperta dhe uli shumezuesin e parase ne 1.65.



Nje anomali tjetere e situates se likujditetit eshte edhe shperndarja e rezervave te teperta. Mbi 60 per qind e likujditeteve te teperta i takojne Bankes se Kur-simit, nderkohe qe mundesite e

saj te kreditimit jane shume me te vogla se thithja e depozitave, nderkohe qe Banka Kombetare Tregtare ka nje mungese strukturese likujditetesh. Pikerisht per te evituar rritjen e metejshme te likujditeteve te teperta nepermjet refinancimit, Banka e Shqiperise ka inkurajuar zhvillimin e tregut nderbankar duke i dhene linjes se refinancimit rendesi minimale. Ne kete kontekst, refinancimi nga Banka e Shqiperise ra ndjeshem sidomos ne tete muajt e fundit te vitit.

Norma e rezervave te detyrueshme mbeti gjate gjithë vitit ne te njejtin nivel, 10 per qind, duke rikonfirmuar faktin qe rezerva e detyrueshme nuk eshte nje instrument aktiv i Bankes se Shqiperise.

4. Politika e Interesave

Në kushtet e ambjentit të sotem ekonomik si dhe duke marrë në konsideratë mungesën e një tregu të zhvilluar të kapitalit dhe letrave me vlerë në Shqipëri, Banka e Shqipërisë ka përdorur kontrollin e drejtpërdrejtë mbi nivelin e interesave, duke u perpjekur t'i japë elasticitet këtij instrumenti. Politika e Bankës së Shqipërisë në fushën e interesave që nga krijimi i saj vazhdon të jetë:

- ① Mbjajtja e interesave reale në nivele pozitive të pranueshme përmes rregullimit gradual të interesit nominal në përputhje me uljen e inflacionit dhe zhvillimet e tjera ekonomike dhe monetare
- ② Zvogëlimi gradual i marzhit të madh midis interesit për kreditë dhe atij të depozitave.

Pika e parë është një nga principet kryesore që udheheqin politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Konsideratat kryesore të kësaj politike konsistojnë në faktin që niveli i lartë i interesave nuk nxit dhe nuk inkurajon investimet dhe prodhimin meqënëse kostoja e huamarrjes bëhet edhe më e lartë. Gjithashtu një nivel i lartë interesash ka efekte frenuese e perkeqësuese edhe për sistemin bankar, kostoja e të cilit rritet ndjeshëm. Nga ana tjetër një nivel i ulët interesash nuk mund të sigurojë kursimet e mjaftueshme në ekonomi të cilat të mund të përdoren për të siguruar investime të qëndrueshme në periudha afatmesme dhe afatgjata. Në përcaktimin e nivelit të interesave është pasur parasysh edhe procesi i liberalizimit të plotë të cmimeve duke nxjerrë në analizë edhe efektet e inflacionit të fshehur.

Me forcimin e tregut primar dhe krijimin e tregut sekondar të letrave me vlerë, niveli i interesave do të fillojë të përcaktohet mbi bazë të kërkesës dhe ofertes në treg dhe gjithnjë e më pak do të përcaktohet mbi baza rregullatore, administrative.

Në Janar të vitit 1992 norma nominale e depozitave të kursimit prej 8 për qind - që në atë kohë kontrollohej nga Banka e Shtetit Shqiptar - e pasuar nga një inflacion vjetor rreth 237 për qind - nënkuptonte një normë reale interesi prej minus 68 për qind. Me një normë të tillë, pas një viti, depozitat njëvjetore do të vlenin vetëm sa 32 për qind e vlerës së tyre fillestare. Në qershor 1992, një muaj pas krijimit të Bankës së Shqipërisë, norma nominale e interesit vjetor u ngrit në 32 për qind duke përgjysmuar pothuajse normën reale negative në minus 39 për qind, ndërsa në Dhjetor të vitit 1992 normat reale të interesit kaluan në nivel pozitiv (0.8 për qind). Në vijimësi, Banka e Shqipërisë ka ndjekur me vëmendje evoluimin e inflacionit dhe

ka përshtatur përqindjet nominale të interesave me parashikimet e saj për inflacionin. Me të vërtetë, normat reale të interesit u rritën në një masë të konsiderueshme gjatë vitit 1993 duke kaluar në muajin Tetor në plus 10 për qind. Në Dhjetor të vitit 1993 norma reale për depozitat njëvjetore rezultoi plus 8 për qind për të vijuar edhe në dy muajt e parë të vitit 1994 në nivele pozitive (Janari 8.2 për qind dhe shkurti 4 për qind).

Eksperiencia e viteve të fundit dëshmon se objektivat e inflacionit janë realizuar (në vitin '93 nga 44 për qind i programuar inflacioni u ul në 30 për qind dhe në vitin 1994 nga 24 për qind i programuar u ul në 15.8 për qind). Banka e Shqipërisë vazhdon të punojë seriozisht që edhe inflacioni i këtij viti të qëndrojë brenda limitit të programuar. Nëse kjo realizohet, në kushtet e normave nominale të depozitave njëvjetore të pandryshuara (në nivelin 14.5 për qind) niveli mesatar i normave reale do të shënonte rreth plus 8 për qind, që përfaqëson një normë mjaft të lartë rendimenti për një investim kaq të sigurt sa depozita e kursimit.

5. Objektivat e Politikës Monetare për Vitin 1995

Objektivat ekonomike të vitit 1995 si pjesë organike e programit ekonomik afatmesëm synojnë rritjen e punësimit nëpërmjet një rritje sasiore dhe cilësore të produktit të përgjithshëm në një afat të gjatë kohe dhe të nivelit të përgjithshëm të jetesës, por gjithmone duke ruajtur një pozicion të ekuilibruar në sektorin e jashtëm të ekonomisë dhe stabilitet në fuqinë blerëse të monedhës. Rritja ekonomike për vitin 1995 është programuar në nivelin 6 për qind, ndërsa objektivi për shpejtesinë e rritjes së cmimeve është që të ulët deri në 10 për qind në fund të vitit 1995; deficitet buxhetorë do të mbahet në 7 për qind të produktit të përgjithshëm; parashikohet të ketë një rritje modeste të rezervave valutore të vendit; dhe si prioritet do të jenë privatizimi masiv i ndërmarrjeve shtetërore dhe zhvillimi i infrastrukurës. Nga ana tjetër, realizimi i këtyre objektivave, do të kontribuojë në zbutjen e metejshme të përqindjes së papunësisë.

Në kuadrin e realizimit të programit ekonomik, objektivi kryesor i politikës monetare është sigurimi i një ekspansioni të tillë monetar, që nëpërmjet një konsumi të moderuar, të nxisë rritjen e prodhimit drejt nivelit të tij potencial (kapacitetit të plotë) duke ruajtur një nivel të pranueshëm inflacioni. Objektivat kryesore afatgjata të Bankës së Shqipërisë në sistemin financiar lidhen në radhë të parë me liberalizimin e sistemit financiar që nënkupton :

- ① kalimin nga instrumentat direkte në ato indirekte
- ② nxitjen e konkurrencës përmes krijimit të bankave të reja private
- ③ liberalizimin e levizjes së kapitaleve

Realizimi i shkallezuar i lehtësimit dhe zgjerimit të tregtisë së jashtme, i mbështetjes së stabilitetit të këmbimeve dhe i eliminimit gradual të kufizimeve në levizjet e kapitalit, është konkretizuar në një sërë ndryshimesh në sistemin e këmbimeve në Shqipëri, ndryshime që u kurorëzuan me liberalizimin e plotë të llogarise korrente e me rregullimin e tregut të këmbimeve valutore. Faza e dytë dhe më e vështirë në këtë proces është konvertibiliteti i llogarise kapitale, projekti i të cilit është në përpunim e sipër nga Banka e Shqipërisë.

Në situatën dhe kushtet e mesiperme, ruajtja dhe forcimi i stabilitetit makroekonomik mbetet prioriteti kryesor dhe kjo thekson me shumë rëndësi që politika monetare duhet të luajë në procesin e rritjes së konkurrencës dhe përmirësimit e shpërndarjes së burimeve financiare në tregun financiar. Siç përmendëm edhe më sipër, përdorimi me shtrengesa i instrumentave të politikës monetare mund të krijojë një pengesë serioze për konkurrencën në treg si edhe për hyrjen e pjesëmarrësve të rinj. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ka punuar dhe po punon seriozisht për të zhvilluar forma dhe mënyra më moderne të kontrollit monetar të orientuara nga ekonomia e tregut.

Mëqenëse në programin tonë ekonomik objektivat për parane gjithsej përcaktohen gjithmone në përputhje me objektivat kryesore makroekonomike, Banka e Shqipërisë për të mbështetur programin e zhvillimit ekonomik të vendit do të përqendrohet kryesisht në *lidhjen midis parase gjithsej dhe bazës monetare*, në teknikat e lidhjes së kërkesës për baze monetare me instrumentat që ndikojnë në ofertën e saj. Këto teknika e instrumenta do të synojnë të kontrollojnë zhvillimet e bazës monetare si dhe të përcaktojnë masën e kesaj baze që do të injektohet, apo do të tërhiqet nga ekonomia. Në këtë mënyrë, hapat e parë të hedhur për të kaluar nga instrumentat direkte, si kufiri i kredisë, në ato indirekte do të konsolidohen edhe më tej në vitin 1995.

Gjendja aktuale e bazës monetare dhe e rezervave të tepërta të bankave në vecanti nuk reflekton kërkesën e ekonomisë për to, por ekzistencën e një mbioferte si pasojë e një deficiti të lartë buxhetor. Kjo është dhe arsyeja përse marrëdhëniet me buxhetin do të jenë në qendër të politikës monetare të vitit 1995. Në funksion të uljes së financimit të drejtperdrejtë nga Banka e Shqipërisë, po punohet për zhvillimin e tregut primar të bonove të thesarit si dhe për krijimin e një tregu të shitjes me pakicë të ketyre letrave me vlerë.

Zhvillimi, zgjerimi e konsolidimi i tregut primar të letrave me vlerë të qeverisë merr tashmë një rëndësi të vecantë. *Se pari*, sepse duke krijuar mundësinë e financimit të një pjese gjithnjë e më të madhe të deficitit buxhetor nga individët dhe kompanitë, nga njëra anë mobilizohen kursimet dhe fondet e lira të tyre dhe nga ana tjetër tkurret baza monetare. *Se dyti*, ky proces do të lehtësonte mjaft edhe sforcimet

financiare te bankave te nivelit te dyte te cilat nuk mund te perballojne me tej koston e depozitave ne rritje, nderkohe qe kane kufizime ne huadhenie. *Se treti*, zhvillimi i ketij tregu do te krijonte premisat qe sistemi bankar te ndertoje gradualisht portofolin e tij te letrave me vlere, portofol qe do te mundesoje nje zevendesim me te shpejte te instrumentave direkte me ato indirekte.

Efektet negativ makroekonomik i shpenzimeve disi me te larta te buxhetit per interesa, eshte pa dyshim mjaft me i vogel se sa efektet crregulluese qe shkaktohen nga financimi i deficitit buxhetor prej kredise te drejtperdrejte nga Banka Qendrore.

Jane hedhur hapat e pare ne drejtim te garantimit te detyrimeve te qeverise ndaj Bankes se Shqiperise me letra me vlere te cilat ne nje kohe te dyte do te sherbejne per te kontrolluar likujditetin ne treg. Po ashtu zhvillime pozitive do te kete edhe ne drejtim te financimeve alternative te buxhetit gjate vitit 1995. Trajtimi sasior i kufirit te kreditit te drejtperdrejte per qeverine do te diktohet ne nje mase te konsiderueshme nga vendosja e objektiveve per rezervat e teperta dhe nga kufizimet ne Ligjin Per Banken e Shqiperise.

Ne se baza monetare nuk vihet nen kontroll, atehere bankat do te vazhdojne te kene likujditete te teperta dhe kjo do te pengonte heqjen e kufijve te kreditit dhe realizimin e objektiveve te politikave monetare edhe pse ekonomia do te ishte e gatshme per te kaluar plotesisht ne instrumenta indirekte. Kjo do t'i detyronte bankat te mosrespektonin kufirin e kredise, do te rriste ndjeshem koston e sistemit bankar dhe do te krijonte padyshim zhbalecime serioze per ekonomine. Ne kushtet e nje zhvillimi te kufizuar te tregut te letrave me vlere dhe kur financimi jomonetar i deficitit buxhetor eshte i paperfillshem, kontrolli i bazes monetare nga Banka e Shqiperise behet pothuaj i pamundur. Ne kete kuader, Banka e Shqiperise per vitin 1995 do te beje financimin e pjesshem te deficitit buxhetor ne nivelin e realizimit te objektiveve te ndermjetme dhe kundrejt sigurimit te kesaj kredie me letra me vlere te tregtueshme. Pervec realizimit te objektiveve ne fushen monetare, kjo do te ndihmoje ne ngushtimin e hapësirës midis pavarësise ligjore dhe asaj praktike te Bankes se Shqiperise.

Ne kete proces, Banka e Shqiperise ka parasysh faktin se ekzistenca dhe perdorimi njekohesisht i instrumentave direkte dhe indirekte mund te krijoje nje komplikim; perdorimi i kufijve te kredise mund te krijoje rezerva te teperta te cilat duhet te ulen ose nepermjet rritjes se rezervave te detyrueshme ose nepermjet shitjes se letrave me vlere nga Banka e Shqiperise. Vetem pasi kjo te jete realizuar, atehere perdorimi i instrumentave indirekte do te behet efektiv.

Instrumentat indirekte te politikës monetare lejojnë një shpërndarje me efektive të burimeve financiare. Për këtë arsye, vendet në zhvillim, në procesin e reformës të sistemit financiar kërkojnë që në zbatimin e politikës monetare të zëvendësojnë instrumentat direkte me ato indirekte.

Instrumentat indirekte duhet të jenë lehtë efektive për kontrollin e të gjitha zhvillimeve monetare dhe të stimulojnë, ose së paku të krijojnë kushte dhe të lejojnë vendosjen e një sistemi financiar që operon mbi bazë të ligjeve të ekonomisë së tregut. Për këtë kuptohet se instrumentat për zbatimin e politikës monetare duhet të jenë në përputhje dhe t'i përgjigjen sistemit financiar në të cilin ato do të operojnë, në të kundërt ato nuk do të jenë efektive dhe do të deshtojnë. Në këto kushte, për ekonomitë në tranzicion, zëvendësimi gradual i instrumentave direkte me ato indirekte duket se është rruga më e përshtatshme për të mbështetur zhvillimin e sistemit financiar dhe për të ruajtur njëkohësisht kontrollin monetar.

Drejtimet kryesore të politikës së Bankës së Shqipërisë në fushën e nivelit të *interesave do të jenë* :

1. Mbajtje e interesave reale në nivele pozitive të pranueshme;
2. Rregullimi gradual i interesit nominal në përputhje me uljen e inflacionit dhe zhvillimet e tjera ekonomike dhe monetare, duke i dhënë vëmendjen e duhur efekteve që sjell kjo në gjendjen e depozitave dhe në kursin e këmbimit;
3. Zvogëlimi gradual i marzhit të madh midis interesit për kredite dhe atij të depozitave.

Marzhet e mëdha që ekzistojnë në bankat e nivelit të dytë janë dëshmi e një kostoje të lartë të ndërmjetësimit bankar, të një portofoli të varfër e të dobët krediti, mungesës së konkurrencës, ekzistencës së problemeve serioze të administrimit financiar, etj..

Më forcimin e tregut primar dhe krijimin e tregut sekondar të letrave me vlerë, niveli i interesave do të fillojë të përcaktohet mbi bazë të kërkesës dhe ofertës në treg dhe gjithnjë e më pak do të përcaktohet mbi bazë rregullatore, administrative. Krijimi i bankave private do të ndikojë në një ndërmjetësim financiar efektiv për ekonominë.

Që instrumentat indirekte të bëhen plotësisht efektive në kontrollin e ekspansionit monetar është e domosdoshme që të plotësohen një sërë kushtesh, për realizimin e të cilave Banka e Shqipërisë po punon me seriozitet. *Se pari*; rezervat e tepërta dhe që mbahen në mënyrë të pavullnetshme nga sistemi bankar pranë Bankës së Shqipërisë, duhet të neutralizohen nëpërmjet shitjes së letrave me vlerë të qeverisë apo të vetë

Bankes se Shqiperise. Ne te kundert efekti i instrumentave indirekte ne nivelin e interesave dhe ne oferten e kredise do te zbehet. Ne kete kuader, ekzistenca e letrave me vlere te qeverise dhe tregu i tyre si edhe krijimi i nje portofoli investimesh ne Banken e Shqiperise eshte shume i rendesishem. *Se dyti*, ne rast se ne synojme qe instrumentat indirekte te influencojne ne nivelin e interesave, atehere duhet qe ky nivel te lihet i lire dhe te percaktohet mbi baze te tregut. Nderkohe, liberalizimi i plote i interesave mund te vere ne rrezik sistemin financiar per aq kohe sa nuk eshte vendosur plotesisht stabiliteti monetar, nuk ekziston nje sistem bankar efektiv dhe konkurrues, tregu i parase eshte i pazhvilluar, etj,. *Se treti*, kur instrumentat indirekte do te funksionojne nepermjet interesit, atehere kerkesa dhe oferta e parase dhe kredise duhet te jene shume te ndjeshme ndaj nivelit te interesit. Ne kete drejtim Banka e Shqiperise po punon per perdorimin me sa me efektivitet te sistemit te refinancimit. *Se katerti*, reforma dhe ristrukturimi i sistemit bankar duhet t'i paraprije ose te pakten te shoqeroje procesin e kalimit drejt perdorimit te plote te instrumentave indirekte te politikës monetare. Ne kete kuader politikat e kreditit marrin nje rendesi te vecante per mbarevajtjen e sistemit bankar dhe mbeshtetjen e rritjes ekonomike te vendit.

KAPITULLI III SISTEMI BANKAR

1. Struktura dhe Ristrukturimi i Sistemit Bankar

Para vitit 1992, struktura e sistemit bankar ne Shqiperi ishte tipike per nje ekonomi te centralizuar. Deri ne fund te 1991 ky sistem permbledhte 3 institucione shtetere: Banken e Shtetit Shqiptar e cila njekohesisht kryente funksione te cingjara te nje banke qendrore dhe te nje banke tregtare; Banken e Kursimeve e destinuar vetem per mbledhjen e depozitave te individeve, qe ridepozitoheshin ne Banken Shtetit dhe ne Banken Bujqesore. Funksioni i kesaj te fundit ishte kreditimi i drejtperdrejte i fermave dhe kooperativave bujqesore. Ne Janar te 1991, u krijua banka e katert shtetere e quajtur Banka Tregtare Shqiptare me qellim administrimin e te gjitha marreveshjeve dypaleshe te kleringut me vendet lindore si dhe realizimin e te gjitha transaksioneve te tregtise se jashtme.

Sistemi bankar dyshkallesh u krijua ne Prill 1992, me miratimin ne Kuvendin Popullor te ligjit " Mbi Banken e Shqiperise " dhe te ligjit " Mbi Sistemin Bankar". Banka e Shtetit Shqiptar u shnderrua ne Banka e Shqiperise dhe fitoi te gjitha funksionet e nje banke qendrore.

Ne 1 janar 1993, Banka Kombetare e Shqiperise dhe Banka Tregtare Shqiptare u bashkuan duke krijuar keshtu Banken Kombetare Tregtare te Shqiperise. Ne tetor 1993, Banka e Zhvillimit dhe e Bujqesise shnderrohet ne Banken Tregtare Agrare dhe te gjitha aktivet dhe depozitat i kalojne bankes se re. Te gjitha bankat tregtare zyrtarisht u lejuan te ushtronin funksionet e tyre si banka universale, duke marre depozita dhe duke dhene kredi si individeve ashtu edhe ndermarrjeve. Duke u ndalur ne zhvillimet e vitit 1993, me gjithë perparimet e bera, perseri te rejat ne kete sistem mbeten relativisht te kufizuara. Keshtu shumica e transaksioneve kryhej ne kartmonedhe, perdorimi i kreditkartave ishte i kufizuar si dhe sherbimet bankare mbeten relativisht te varfera.

Fillimi 1994 e gjeti sistemin bankar sipas skemes se meposhtme:

Bankat	Pronesia
Banka e Shqiperise	Shtetere
Banka Kombetare Tregtare	Shtetere
Banka e Kursimeve	Shtetere
Banka Tregtare Agrare	Shtetere
Banka Italo Shqiptare	Joint-venture (Banca di Roma Italia)
Banka Arabo Shqiptare Islamike	Joint-venture
Dardania Bank	Banke e huaj private

Megjithate sistemi bankar vazhdon te karakterizohet nga segmentimi i tregut dhe specializimi. Konkretisht, Banka e Kursimeve vazhdon te mbaje nga njera ane 85 per qind te gjithe depozitave te kursimit te qytetareve, dhe nga ana tjeter vetem 7 per qind te totalit te kredise. Nderkohe Banka Kombetare Tregtare zoteron mbi 70 per qind te depozitave te ndermarrjeve dhe 90 per qind te totalit te kredise.

Banka e Shqiperise ne cilesine e autoritetit monetar te vendit ka synuar te rrise efektivitetin e politikës monetare, te kembimeve valutore, te mbikeqyrjes se sistemit bankar dhe te reformave te sistemit financiar ne pergjithesi. Pas konsolidimit te embrionit te politikës dhe kontrollit monetar, qe filloi me vendosjen e rezervave te detyrueshme, refinancimin dhe me nje politike te kujdesshme te interesave, Banka e Shqiperise perqendroi fokusin e saj ne projektin e administrimit te likujditetit nderbankar nepermjet perdorimit te instrumentave indirekte. Krijimi i tregut te Bonove te Thesarit ne gjatemujorin e dyte te vitit 1994, shenoi fillimin e financimit jomonetar te deficitit buxhetor dhe te forcimit te kontrollit mbi zhvillimet e bazes monetare.

Ne vijim te adoptimit te nje regjimi fleksibel kembimi, Banka e Shqiperise liberalizoi me tej sistemin e kembimeve valutore duke hequr kufizimet per transaksionet korrente.

Ne maj te vitit 1994, Banka e Shqiperise miratoi paketen e rregullave per licensimin e bankave tregtare. Pergjithesisht, keto rregulla synojne qe te sigurojne nje veprimtari efikase te bankave, permes informacionit mbi gjendjen financiare, personalitetin, besueshmerine e kerkuesit, si dhe reputacionin, aftesine profesionale dhe besueshmerine e pronareve dhe te drejtuesve. Futja e institucioneve financiare private, te huaja apo vendase me siguri do ta pershpjetoje transformimin e sistemit bankar drejt nje ndermjetesimi financiar me efektiv.

Drejtimet kryesore te zhvillimit te sistemit bankar, permbledhen ne permiresimin e sistemit te pagesave dhe te kontabilitetit, te sherbimeve bankare, uljen e kostos se ndermjetesimit bankar si dhe ne ngritjen cilesore te administrimit te portofolit.

2. Mbikeqyrja dhe roli i saj ne Sistemin tone Bankar

Funksionet dhe detyrat kryesore te Departamentit te Mbikeqyrjes gjejne mbeshtetjen ligjore ne Ligjin "Per Banken e Shqiperise", sipas te cilit Banka e Shqiperise eshte eskluzivisht pergjegjese per licensimin e bankave te nivelit te dyte si dhe mbikqyrjen e te gjitha enteve qe veprojne si banke ne Republiken e Shqiperise.

Ne funksion te plotesimit te rolit te saj mbikeqyrja bankare gjate vitit 1994 ka plotesuar dhe permiresuar ane te vecanta apo komponente te veprimtarise bankare ne bankat e nivelit te dyte. Keshtu rregullorja e re e hartuar "Per dhenien e licensave per te vepruar si banke ne Republiken e Shqiperise" (vendimi Nr.1 dt.12.05.94) krijon kushte dhe hapësira per terheqjen e kapitaleve te vendit dhe te huaja, ne fuqizimin dhe diversifikimin e veprimtarise bankare si dhe per mireadministrimin financiar dhe kapitalizimin e bankave ne Shqiperi. Hartimi i ri i rregullores per licensimin e bankave private, e cila ne krahasim me rregulloren e meparshme permban disa lehtesime proceduriale, do te nxise me tej ofertat perspektive.

Po ashtu normat e miratuara per nivelin maksimal te kredise te hartuara ne 1993, u permiresuan me nje rregullore te re te dt. 1.07.94 ne te cilen Bankave tregtare ju krijohen me shume mundesi veprimi duke patur parasysh shmangien e rreziqeve nga perqendrimi i kreditit ne nje numer te kufizuar huamarresish dhe gjendjen e renduar te portofolit qe keqesohet vazhdimisht, te stokut te krijuar. Me kete rregullore u caktua norma per nivelin maksimal te kredise edhe per bankat e krijuara gjate vitit 1994 si Banka Italo-Shqiptare, Banka Arabo-Shqiptare Islamike dhe Banka Dardania.



Ndryshimet ne rregulloren "Per mjaftueshmerine e fondeve te veta te bankave" qe hyri ne fuqi ne qershor 1994 u bene per t'ju pershtatur kushteve te reja ekonomike. Sipas ketij ndryshimi, per bankat me kapital te shtetit Shqiptar, per bankat e perbashketa te shtetit Shqiptar dhe kapital te huaj si dhe per deget e bankave te huaja qe u perkasin vendeve te OECD-se, norma e mjaftueshmerise se kapitalit eshte jo me pak se 8 per qind, ndersa per bankat e tjera kjo norme eshte jo me pak se 15 per qind.

Rregulloret dhe normat qe jane nxjerre e plotesuar kane synuar zhvillimin e Sistemit Bankar ne menyre qe te investohet kapitali vendas dhe i huaj, qe veprimtaria bankare te zgjerohet, efektiviteti i saj te permiresohet, qe depozitat e klienteve te rriten, qe sherbimet bankare te zgjerohen dhe standartizohen, qe kerkesat e personelit te njesohen ose te pakten te perafrohen me standartet e kohes, qe te zhvillohet konkurrenca midis bankave etj. Ne kete kuader nje nga synimet e Bankes se Shqiperise ke qene qe krahas zgjerimit te veprimtarise bankare normat e mbikeqyrjes te unifikohen ndermjet bankave te nivelit te dyte dhe te standartizohen me bankat bashkekohore. Nje drejtim me rendesi te vecante ke qene edhe mbikeqyrja ne vend e veprimtarive bankare, efektiviteti ne administrimin teresor te saj si dhe te fondeve, po ashtu dhe roli i organeve drejtuese, mbikeqyrese dhe kontrollit ne keto banka. Per here te pare gjate vitit 1994 u kryen nga firma te huaja inspektimi i aktivitetit kreditues te nje banke te nivelit te dyte.

KAPITULLI IV KREDITI BRENDSHEM GJATE VITIT 1995

1.Kreditimi per Ekonomie

Ne vijimesi te vitit te kaluar, nxitja me kredi e sektorit privat mbeti perparesi e politikese kredituese te sistemit bankar. Sistemi Bankar i dha nderkohe ekonomise 7375.3 milione leke kredi dhe arketoi ne formen e shlyerjeve 4992.3 milione leke. Ne kete periudhe, bie ne sy rritja mjaft e madhe e kredise per sektorin privat, i cili perfitoi afro 74 per qind te gjithe kredise. Nga kredia gjithsej ai mori si kredi afatshkurter 69 per qind te saj. Dominon kredia per aktivitet tregtar, ndersa kredia afatgjate per privatet ne pjesen me te madhe eshte dhene per blerje mjetesh mekanike ne bujqesi, ndertime etj.. Ne sektorin shtetror kredia afatgjate eshte perqendruar per ndertimin e banesave nga Enti Kombetar i Banesave, ndersa kredia afatshkurter eshte dhene me teper per industrine e rende e minierat, ndermarrjet bujqesore etj.



Gjate vitit 1994 u shpermdane 3700 milione leke kufi kredie per ekonomine, i cili u perdor vetem ne masen 64.4 per qind. Karakteristike e kesaj periudhe eshte se kufiri i kredise nuk ka qene pengese per dhenien e saj. Ai ka qene i mjaftueshem por duhet thene se bankat e nivelit te dyte kane hezitur te kreditojne kryesisht per ritmin e larte te rritjes se kredive te pakthjera ne afat. Dukuria e mosperdorimit te kredise u shfaq qe ne tremujorin e dyte, prandaj edhe perdorimi i kufirit te kredise ishte ne keto kufij vjetor. Banka Kombetare Tregtare jo vetem nuk e perdori kufirin e kredise, por uli tepricen e saj te kredise per ekonomine me 12 per qind te kufirit duke synuar permiresimin, apo moslejimin e keqesimit te likujditetit. Banka e Kursimeve perdori afro 74 per qind te kufirit dhe ajo Tregtare Agrare e tejkaloj me rreth 3 per qind.

Kredia per ekonomine (dhene serishmi)

(ndryshimi ne mln leke)

	1993	T1	T2	T3	T4 - 94
Kredia e re gjithsej	10291.6	1818.1	1919.4	2037.6	1599.6
Kredia e re gjithsej (ne per qind)	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
<i>A. Sipas afateve</i>					
1. Kredia afatshkurter	74.1	71.1	63.3	70.4	72.0
2. Kredia afatmesme	0.0	4.0	4.1	6.4	7.0
3. Kredia afatgjate	25.9	24.9	32.6	23.2	21.0
<i>B. Sipas sektoreve</i>					
1. Sektori shteteror	47.1	47.4	16.0	18.8	22.1
2. Sektori privat	52.9	52.9	84.0	81.2	77.9
<i>C. Sipas monedhes</i>					
1. Kredia ne leke	90.4	77.5	97.8	90.5	83.9
2. Kredia ne valute	9.6	22.5	2.2	9.5	16.1

Ne fund te vitit gjendja e kredive te pakthjera ne afat per te gjithe Sistemin Bankar arriti ne 2452 milione leke, qe perfaqeson rreth 27 per qind te teprices se kredise ne fund te periudhes. Nga kjo kredi e pakthyer sektorit privat i takon 32.6 per qind dhe 39 per qind eshte afatshkurter. Kredia e pakthyer ne afat vazhdon te jete nje problem mjaft shqetesues i bankave te nivelit te dyte qe mund te vere ne rrezik realizimin e objektivave per rritjen e prodhimit te pergjithshem dhe te investimeve.

Kredia per ekonomine

(gjendje ne fund te periudhes, mln leke)

	1993	T1	T2	T3	T4-94
Kredia gjithsej	6776.7	7565.5	8235.9	9012.0	9214.7
<i>A. Sipas afatave</i>					
1. Kredia afatshkurter	4046.7	4438.3	4574.6	4946.2	4961.9
2. Kredia afatmesme	290.5	330.2	402.8	489.0	591.6
3. Kredia afatgjate	2439.5	2797.0	3258.5	3576.8	3661.2
<i>B. Sipas sektoreve</i>					
1. Sektori shteteror	2475.6	2949.5	2542.8	2562.5	2419.4
2. Sektori privat	4301.1	4616.0	5693.1	6449.5	6795.3
<i>C. Sipas monedhes</i>					
1. Kredia ne leke	6313.4	6871.3	7650.1	8324.3	8337.0
2. Kredia ne valute	463.3	394.2	585.8	687.7	877.7

2. Situata e buxhetit te shtetit gjate vitit 1994

Per vitin 1994, treguesit e buxhetit te shtetit u realizuan ne perputhje me Programin e Zhvillimit Ekonomik, duke mbajtur nen kontroll kredine per Qeverine.

Deficiti buxhetor gjithsej ne fund te vitit 1994 arriti ne shifren 13.776 miliarde leke ose 8.15 per qind e GDP-se. Deficiti i brendshem i Qeverise per vitin 1994 rezultoi 13.084 miliarde leke, qe perfaqeson 7.7 per qind te GDP-se vjetore duke qendruar brenda kufirit prej 13.133 miliarde leke te percaktuar ne Programin Monetar. Duke pare ecurine ne vite, vihet re nje permiresim ne masen e deficitit buxhetor ne perqindje te GDP-se. Keshtu, nga 17.5 per qind te GDP qe zinte ne vitin 1992, u ul ne 10.4 per qind ne 1993 dhe ne 7.7 per qind ne 1994.

Shpenzimet buxhetore u realizuan ne masen 32 per qind e GDP-se. Nje peshe te madhe ne shpenzimet e Qeverise zene pagat, sigurimet shoqerore dhe mbrojtja sociale. Shpenzimet per pagimin e interesave bankare perbejne rreth 10.4 per qind te shpenzimeve gjithsej nga 7 per qind qe zinin vitin e kaluar. Ashtu si ne dy vitet e kaluara, bie ne sy aritmika e kryerjes se shpenzimeve. Pothuajse gjysma e shpenzimeve buxhetore u kryen muajin e fundit te vitit, duke shkaktuar nritjen e deficitit buxhetor, ne masen 104 per qind, pra sa deficitit i 11 muajve te pare te vitit.

Ne strukturen e te ardhurave, ne fund te vitit 1994, te ardhurat nga tatime e taksa si dhe te ardhura te tjera jotatimore perbejne 88.4 per qind te totalit te te ardhurave, nga 85 perqind qe zinin ne te njejten periudhe te vitit te kaluar. Ne perqindje te GDP-se vjetore, keto te ardhura llogariten 21.1 per qind. Per


vitin 1994, ne keto te ardhura u perfshine edhe te ardhurat nga tatime e taksa ne valute, te cilat ndikuan ne uljen e kredise neto per Qeverine.

Te ardhurat nga ndihmat ne ushqime dhe lende te pare rezultojne me renie prej 6.3 per qind krahasuar me nje vit me pare. Ne vlere absolute ato llogariten ne rreth 4.3 miliarde leke, ose ne 10.5 per qind te totalit te te ardhurave. Ne strukturen e te ardhurave, ne fund te vitit 1994, duket qarte zbehja e kontributit te te ardhurave nga ndihmat dhe rritja e peshes se te ardhurave nga tatimet e taksat.

3. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij

Banka e Shqiperise e financoi direkt 91.1 per qind te ketij deficiti, qe perben dhe nivelin maksimal te programuar te kreditimit direkt te Qeverise per vitin 1994. Pa dyshim, masa e ketij kreditimi krijoi nje sere efektesh negative ne zhvillimet monetare duke ndikuar me pas ne perqindjet e interesit, ne perqindjen e inflacionit dhe ne kursin e kembimit.

Financimi i brendshem i deficitit i ruajti kufijte e vendosur ne Programin Monetar. Njekohesisht, ai shenoi nje arritje te suksesshme krahasuar me dy vitet e shkuara, duke e ulur financimin direkt me kredi nga Banka e Shqiperise. Kjo u be e mundur me krijimin dhe venien ne funksionim me sukses, ne gjashtemujorin e dyte te vitit, te tregut te letrave me vlere te Qeverise. Si rezultat i funksionimit te ketij tregu, u arrit financimi i deficitit te brendshem ne masen rreth 8 per qind.



Nga ana tjeter, ekzistenca e ketij tregu dhe njekohesisht aplikimi i kolateraleve ne refinancimin nga Banka e Shqipe-rise, ju jep mun-desine bankave te nivelit te dyte qe te krijojne porto-folin e tyre te

letrave me vlere gje qe do te ndikojne ne permiresimin e aftesive te tyre likujduese. Per kete qellim, jane te percaktuara konkretisht si kolaterale, midis te tjerash, letrat me vlere te Qeverise te tregtueshme me afat maturimi deri ne nje vit. Keshthu, zhvillimi i metejsheem i tregut te letrave me vlere, sidomos krijimi i tregut sekondar do te mundesoje riskontimin e letrave me vlere te tregtueshme te vendosura prane Bankes se Shqiperise nga bankat e nivelit te dyte.


Ne fazen fillestare, Qeveria emetoi letra me vlere afatshkurtra, Bono Thesari, me maturim 90 dhe 182 dite, te tregtueshme vetem ne Banken e Shqiperise, e cila duke vepruar si agjent i Qeverise, organizon shitjen e tyre ne ankande qe zhvillohen nje dhe dy here ne muaj.

Shitjet ne total te Bonove te Thesarit gjate 6-mujorit arrijne ne 1.4 miliarde leke. Yieldi mesatar vjetor per Bonot e Thesarit me maturim 3 mujor eshte ulur nga 16, dhe 16.6 perqind qe ka qene respektivisht ne dy ankandet e para te zhvilluara ne Korrik dhe Gusht, ne 10 per qind ne Dhjetor. Yieldet per bonot me maturim 6 mujor kane ndjekur nje diagrame jo te rregullt, nga 15 per qind ne emetimin e pare te tyre ne Shtator, ne 17.5 per qind dhe 12.14 per qind perkatesisht ne Nentor dhe Dhjetor. Shumica e bonove te emetuara, ne masen mbi 80 per qind, eshte blere nga sistemi bankar, pjesa tjeter nga institucione financiare, ndersa firmat private dhe individet zene mesatarisht rreth 1.5 per qind. Ne kete drejtim ka ndikuar mungesa e publicitetit ne pershtatje me ndryshimet ne nivelin e tregut, nevoja e pasqyrimet ne interesin e ankandit te nje interesi real tregu, si dhe domosdoshmeria e krijimit te nje tregu sekondar ose i nje tregu te shitjes se tyre me pakice ne sistemin bankar.

KAPITULLI V BILANCI I PAGESAVE

1. Llogaria Korrente dhe Levizjet e Kapitalit gjate Vitit 1994

Ne dallim nga suficiti i lehte i nje viti me pare, Llogaria korrente ne fund te vitit 1994 u mbyll me nje deficit prej 164 milione dollare amerikane. Deficiti u rrit gjate gjithë vitit per t'u mbyllur ne tremujorin e katert me nje deficit 80 per qind me te larte se ai i tremujorit te pare. Keto rezultate negative te llogarise korrente jane pasoje direkte e renies se menjehershme te transfertave korrente shtetere nga jashte. Nga ana tjeter deficiti korrent perjashtuar transfertat shtetere shenoi nje permiresim me 16 per qind. Permiresimi erdhi si rezultat i nje efekti te kombinuar ne aktivitetet e tregtise se jashtme, sherbimeve dhe te ardhurave. Ky deficit perben 14 per qind te GDP kundrejt 27 per qind te GDP qe ishte ne fund te vitit 1993.




Shqiperia me nje volum tregtie prej 742 milione dollare (29 milione me i larte se ne vitin 1993) ne tregtine e jashtme, e mbylli vitin 1994 me deficit. Bilanci tregtar ishte negativ per te

gjithe tremujoret e vitit 1994. Ne dallim nga viti i kaluar kemi nje shperndarje me te mire te deficitit tregtar. Ai i gjashtemujorit te dyte ishte vetem 17 per qind me i larte se i te parit, nderkohe qe ne 1993 kjo shifer ishte 43 per qind.

Rritja e vellimit te eksporteve e shoqeruar nga nje import i pandryshueshem, ne fund te 1994 e uli deficitin tregtar me 6 per qind kundrejt vitit te kaluar duke shenuar 460 milione dollare ose 26 per qind te GDP (ky raport ishte 44 per qind ne 1993). Ky deficit perfshin mallrat ndihma qe ne vitin 1994 perbenin vetem 35 per qind te ndihmave te 1993, deficiti tregtar pa keto mallra do te ishte 411 milione dollare qe do te thote se ekonomia ka perballuar vete 90 per qind te deficitit te tregtise se jashtme. Deficiti tregtar i shprehur ne leke per vitin 1994 ishte 43.3 miliard leke, krahasuar me 50 miliard nje vit me pare. Nga i gjithë volumi i tregtise se jashtme vetem 30 per qind e tij kane kaluar nga bankat, pjesa tjeter e tij eshte realizuar ne "cash".

Eksportet ne vitin 1994 u rriten 30 milione dollare ose 26 per qind me shume se ne vitin 1993. Vellimi i eksporteve qendroi pothuaj kostant gjate tre 3-mujoreve te pare te vitit dhe pati nje ngritje te menjehershme me 67 per qind ne tremujorin e fundit, qe erdhi si rezultat i eksporteve te larta te

produkteve me material te porositesit dhe ato te te industrise nxjerrese dhe perpunuese te metaleve me ngjyre. Ne totalin e eksporteve vazhdojne te dominojne mallrat industriale. Brenda ketij grupi peshen kryesore e mbajne produktet me material te porositesit me rreth 40 per qind te totalit te eksportit, qe pasohet nga industria nxjerrese dhe perpunuese e metaleve me ngjyre me 19 per qind te totalit te tij. Grupi ushqime pije duhan ruajti vendin e trete por kete vit vetem me 9 per qind te totalit te eksporteve krahasuar me 19 per qind ne 1993.



Importi i mallrave, arriti shi-fren prej 601 milione dollare e cila eshte e njejte me ate te vitit 1993. Vle-ra e importeve pa perfshire ndihmat lloga-ritet 553 mili-one dollare, e cila duke u krahasuar me vitin

1993 eshte rritur 19 per qind. Importet ndihma rane nga 136 milione dollare ne 48 milione dollare ose 2.8 here krahasuar me vitin 1993. Ecuria e importeve tregon se ato paten nje tendence ne rritje gjate vitit per te kapur vleren maksimale ne tremujorin e katert me 174 milione dollare. Zvogelimi i vellimit te ndihmave ne pjese me te madhe u kompensua nga rritja e importit te karburanteve (rreth 30 here ne krahasim me vitin e kaluar) qe perbejne 7 per qind te totalit te importit. Sektori privat ze pjesen dermuese te importeve, me rreth 93 per qind te totalit.

Ashtu si edhe ne 1993 importet dominohen nga mallrat ushqimore me 20 perqind te totalit te importeve qe pasohen nga automjetet me 10 per qind dhe paisjet elektro-shtepiake me 9 per qind. Importi i makinerive e paisjeve per investime ra ne 7.6 per qind te totalit te importit nga 13.8 per qind ne 1993.

Bilanci tregtar me te gjitha shtetet ishte negativ. Tregtia e jashtme vazhdon te jete teresisht e orientuar me vendet e Evropes Perendimore, megjithate verchet nje zgjerim ne aktivitetin tregtar me vendet fqinje e ato Lindore. Tregjet kryesore te importit ishin Italia me rreth 33 perqind, Greqia me 21 perqind, Bullgaria me 7 perqind dhe Gjermania 6 per qind.

Gjate vitit 1994 u blene nga jorezidentet nje total sherbimesh prej 133 milione dollare, nderkohe qe iu shitem atyre vetem 79 milione dollare sherbime. Keshtu bilanci i sherbimeve u mbyll perseri me shifra negative, megjithate 1994 shenon nje ngushtim te ketij deficiti me 42 per qind, pesha e tij ndaj GDP ra nga 8 per qind ne 3 per qind. Situata me e mire ishte pasoje e permiresimeve te vogla ne te gjitha zerat e sherbimeve dhe erdhi kryesisht si pasoje e uljes se importit te sherbimeve.

Ne totalin e deficitit të shërbimeve "shërbimet e transportit" zënë 50 për qind të tij. Ky deficit në pjesën më të madhe erdhi si rezultat i shërbimeve të transportit të mallrave që janë drejtperdrejt të varura nga aktiviteti i tregtisë së jashtme. Ky deficit ishte 36.3 milionë ose 4 për qind më i ulët se në 1993.

Turizmi si aktiviteti kryesor arketues i shërbimeve u paraqit pak a shumë si një vit më parë. Të ardhurat nga turizmi për vitin 1994 vlerësohen në 58.3 milionë dollarë (që përbejnë 73 për qind e kredive të shërbimeve). Mëqenëse turizmi është një aktivitet sezonal të ardhurat prej tij paten një tendencë në rritje për të arritur pikun në tremujorin e tretë me 21 milionë dollarë. Efekti negativ i zvogelimit me 6 për qind të numrit të turistëve u kompensua nga rritja e kostos së kohës qëndrimit që erdhi si pasojë e përmirësimit të infrastrukturës së këtij aktiviteti. Në përmirësimin e bilancit të shërbimeve të udhëtimit ndikuan dhe reduktimi me 20 për qind i importit të këtyre shërbimeve. Të gjithë zërat e tjere të shërbimeve paraqiten në një gjendje më të mirë krahasuar me vitin 1993 dhe paten një ndikim të vogël në përmirësimin e deficitit të bilancit të shërbimeve.

Të ardhurat rezultojnë me një bilanc të lehtë pozitiv prej 13.8 milionë dollarë. Krahasuar me vitin 1993 ky suficit ishte 2.5 herë më i ulët. Rritja e të ardhurave nga interesat me 65 për qind kundrejt vitit të kaluar nuk mundi të kompensonte tkurrjen prej 25 për qind të të ardhurave nga puna. Nga ana tjetër marrëveshja për riskedulimin e borxhit publik si dhe rritja e numrit të huave beri që pagesat për interesat e paguara të rriten 33 për qind kundrejt 1993.

Transferrat në mallra dhe shërbime (private e shtetërore) ndihmuan në ngushtimin e deficitit të Llogarisë Korrente me dy të tretat e tij, pa mundur ta kalojnë atë në suficit. Rënia drastike dhe e qëndrueshme e transfertave shtetërore ishte një nga fenomenet më të dukshme në bilancin e pagesave për vitin nën vëzhgim. Shkak për pakesimin e ndihmave në mallra ishte përfundimi i programit të ndihmave kryesisht ushqimore nga Komuniteti Evropian. Ky fenomen pati një ndikim të drejtperdrejt në strukturën e këtyre transfertave, në favor të asistencës teknike që këtë vit zënë 30 për qind të totalit nga 16 për qind në 1993, ndërkohë që ndihmat në kesh ishin fare të papërfillshme. Transferrat shtetërore këtë vit ishin vetëm 5 për qind e GDP nga 27 për qind të GDP dhe 57 për qind të GDP përkatësisht në vitin 1993 e 1992. Tendencë në rënie me 4 për qind shfaqen dhe transfertat private që e mbyllën vitin me 264 milionë dollarë. Struktura e këtyre transfertave vazhdon të dominohet nga keshi me 94 për qind. Pritet një rënie e mëtejshme e këtyre transfertave në të ardhmen.

2. Importi i Kapitaleve

Edhe gjatë vitit 1994 ekonomia Shqiptare u paraqit si një importuese kapitali. Llogaria Kapitale u mbyll me një bilanc pozitiv prej 88.2 milionë dollarë që u shkaktua nga hyrje të mëdha të kapitalit në formë investimesh, huamarrjesh e kredish tregtare. Krahasuar me vitin 1993 importi i kapitalit u ul 22

milione dollare. Investimet e huaja vleresohen ne 53 milione dollare. Keto investime jane drejtuar kryesisht ne industrine e naftes e te gazit, ne turizem, industrine ushqimore etj.


Viti 1994 u karakterizua nga hyrje te larta te huave shtetore nga jashte, qe ne fund te vitit arriten shumen 93.6 milione dollare ose 45 per qind me te larta krahasuar me vitin 1993. Shifrat e larta te huave ne tremujorin e pare u ndikuan nga marreveshja per zhbllokimin e borxhit te jashtem (ne Mars u nenshkrua me Klubin e Parisit marreveshja per riskedulimin e borxhit publik me nje total prej 40 milione dollare). Huadhenesit kryesore te Shqiperise jane Banka Boterore, Fondi Monetar Nderkombetar, Gjermania, Italia etj. Kapitalet e siguruara gjate vitit 1994 nga "Kredite Tregtare" jane 7.3 milione dollare, krahasuar me vitin e kaluar influksi i kredive tregtare u pakesua me 3.5 milione dollare.

Investimet shqiptare jashte dhe konkretisht "Depozita" te bankave tona tregtare u karakterizuan nga dalje te larta te kapitalit qe arriten kulmin ne tremujorin e trete 42.6 milione dollare, dhe qe ne fund te vitit rezultuan 79.4 milione dollare ose 40 per qind me te larta se ne vitin 1993.

Viti 1994, permiresoi dukshem dhe bazen rregulluese te hyrjeve dhe te daljeve te kapitalit ne Shqiperi. Per te nxitur investimet e huaja cdo investitor i huaj, ne perputhje me Ligjin "Mbi investimet e huaja ne Shqiperi", mund te transferoje kapitalin e tij . Gjithashtu, transferimi i kapitalit nga jashte-brenda nga rezidentet e jorezidentet, transferimi i kapitalit nga brenda-jashte qe perfaqeson hyrjet e regjistruara paraprakisht te kapitalit, transferimi i te ardhurave nga terheqja e depozitave nga jorezidentet si dhe transferimi i fondeve nga brenda-jashte prej nje emigranti ne momentin e largimit te tij nga Shqiperia, perbejne rastet e tjera ne te cilat aprovimi nga Banka e Shqiperise nuk eshte i nevojshem.

3.Zhvillimet ne Rezerven Valutore dhe Administrimi i saj

Viti 1994 shenoi nje rritje te rezervave me 54.9 milione dollare amerikane ose 48 per qind krahasuar me rritjen e nje vitit me pare. Rritja e mjeteve te rezerves erdhi teresisht nga rritja e rezervave ne mjete valutore. Ne fund te vitit 1994 stoku i rezervave valutore kapi shumen 204.74 milione dollare amerikane, shume e cila shenon dhe kuoten me te larte te saj qe pas fillimit te Reformes Ekonomike.



Per 1994, niveli mesatar vjetor i rezerves se perdorshme valutore shprehur ne jave import ka qene 12.7 jave nga 12 jave import qe ishte objektivi per kete vit. Dinamika e rezerves

gjate vitit 1994 tregon nje prirje ne nritje te kushtezuar nga pagesat ne emer te qeverise per shlyerjen e borxhit te jashtem ne kuadrin e termave te references se percaktuar nga Klubi i Parisit. Pagesat totale vjetore ne kuadrin e ketyre marreveshjeve kapin nje shume prej 13.5 milione dollare amerikane.

Faktori kryesor qe ka ndikuar ne nritjen e rezervave valutore ka qene kredia e levruar nga FMN (marreveshja ESAF) per nje shume totale prej 22.19 milione dollare amerikane. Ndikim jo te vogel kane pasur edhe kredite ne valute te levruara ne emer te Qeverise qe sipas vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 127 date 25.3.1994 eshte detyruar t'ia shesi Bankes se Shqiperise ne momentin e hyrjes se tyre. Ky faktor ka ndikuár me nje nritje te kesaj rezerve me 16.73 milione dollare amerikan (nga IDA 8.24 milione dhe nga OECF 8.49 milione).

Politika e kurseve te kembimit e ndjekur nga ana e Bankes se Shqiperise (nje kurs kembimi fleksibel i shoqeruar edhe me menjanimin e levizjeve te medha e te menjehershme te tij me ane te nderhyrjeve) ka ndikuar ne nritjen e rezerves se pergjithshme valutore per 21.82 milione dollare amerikane. Nje ndihme jo te vogel ka dhene dhe hapja e sportelit te kembimeve valutore prane Bankes se Shqiperise i cili ka ndikuar jo vetem ne zhvillimin e tregut te kembimeve valutore por dhe ne pjesemarrjen e Bankes se Shqiperise ne tregun paralel (veprimet ne kete treg kryen me kesh). Ne kete sportel jane blere 6.4 milione dollare amerikan kryesisht ne tremujorin e trete ku dhe nevoja e nderhyrjes se Bankes se Shqiperise ishte me e madhe (frenoi rivleresimin e metejshe me te lekur pasi kishte oferte te madhe ne valute).

Persa i perket politikës se ndjekur per administrimin e rezerves valutore, pergjithesisht ajo synoi ne shtimin e nivelit te rezervave valutore si dhe ne gjetjen e instrumentave me te pershtatshem per investimin e saj, brenda nje shporte monedhash te percaktuar. Megjithate, kjo politike u kushtezua ne mase te konsiderueshme nga ekzistenca e borxhit te jashtem, prania e te cilit zvogeloi ndjeshem numrin e bankave te huaja ku do te investohej kjo rezerve. I vetmi instrument i perdorur ka qene depozitimi ne bankat e huaja me nje norme fitimi prej 3.42 per qind krahasuar me stokun e rezerves ne fund te periudhes.

Duke veshtruar kompozimin e rezervës valutore, vendi i parë takoi dollarit amerikan me rreth 60 per qind të totalit të rezervës. Monedhat e tjera të rëndësishme ishin marka gjermane dhe ECU me respektivisht 20 dhe 18 per qind.

Per të rritur efektivitetin në administrimin e rezervave zyrtare, po shihet mundësia për plotësimin e legjislativës që rregullon këto aktivitete. Në ndryshimet e propozuara objektivi primar në zgjedhjen e mjeteve të rezervave valutore dote jete siguria e tyre dhe likuiditeti. Banka e Shqipërisë duhet të mbajë rezervën ndërkombëtare në një nivel të mjaftueshëm për zbatimin e Politikës monetare dhe të këmbeve valutore të vendit si dhe për likuiditetin e menjëhershëm të transaksioneve ndërkombëtare të Shqipërisë. Një vend të rëndësishëm ze dhe kompozimi i rezervës duke filluar që nga zotërimet në ar deri në zotërimet në letra me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet e huaja, bankat qendrore ose organizatat financiare ndërkombëtare publike.

4. Tregu i Këmbeve Valutore

Gjatë vitit 1994 ndryshimi i interesave në favor të dollarit që në të vërtetë megjithëse pa efektet e parashikuara me kursin e këmbimit. Shkurtime të 1994 dollari amerikan e nisi me një prirje të re, gjë që i bëri shumë pjesëmarrës në treg ta kishin të vështirë ta pranonin këtë si të vërtetë. Kështu, Fed-i i rriti për herë të parë përqindjet e interesave nga 3 në 3.25 per qind duke mos patur ndikimin që pritej. Konfliktet tregtare midis SHBA dhe Japonisë çuan në një rënie të dollarit në këtë periudhë. Të dhënat pozitive të ekonomisë Amerikane me pas rriten spekulimet për një rritje të metejshme të përqindjeve të interesave. Në fund të Prillit, Fed-i i rriti për të tretën herë përqindjet e interesave në 3.75 per qind, ndërsa Bundesbank-u vazhdoi politikën e uljes së normave të interesit. Nderkohe tregu i bonove vazhdoi të ulej, gjë që ndikoi negativisht në kursin e dollarit. Kështu si faktor primar në kursin e këmbimit ishte levizja në tregun e bonove dhe të kapitaleve së sa politika e normave të interesit. Rënia e dollarit u ndal për kohë të gjatë në maj në nivelin 1,6320 marka gjermane, niveli më i ulët i vitit, kur Fed-i i ndjekur dhe nga shumë banka evropiane ndërhyne për të mbështetur dollarin. Megjithatë dollari vazhdoi të zhvlerësohej, duke krijuar një mosbesim për të në treg. Mbledhja e G-7 në Napoli në Korrik nuk i kushtoi rëndësi të vecante forcimit të dollarit. Kështu, ai arriti në 1,5160 marka, niveli më i ulët gjatë 20 muajve të fundit.

Shifrat e shpallura në fund të Korrikut të cilat tregonin për një ngushtim të deficitit tregtar të SHBA me Japoninë ndihmuan për një ripërtëritje të dollarit. Në Gusht, dollari filloi perseri të luhet me një prirje uljeje, si rrjedhim i një ngritje të papritur të normave zyrtare të interesit nga disa banka qendrore evropiane, megjithëse Fed-i rriti perseri përqindjet e interesave me gjysëm pike duke arritur në 4.75 per qind. Gjatë kësaj kohe kursi i këmbimit të dollarit kundrejt jenit japonez u ndikua pozitivisht nga komentet pozitive për negociatat midis Japonisë dhe SHBA, duke u bërë si një barometer që maste gjendjen e këtyre bisedimeve. Po kështu shifrat pozitive të ekonomisë amerikane të botuara në Shtator ndikuan që dollari të jete i qëndrueshëm në nivelet 1,54/ 1,55 marka gjermane. Në të njëjtën kohë kjo rriti frikën e inflacionit dhe shkaktoi një dobësim të tregut të bonove dhe të kapitaleve.

Pas fitores se Kohlit ne Gjermani, dollari ra ndjeshem ne nivelin me te ulet per keto dy vitet e fundit, ne 1,49 marka, kurse ndaj jenit u dobesua me pak pasi Banka e Japonise nderhyri duke blere dollare ne treg. Kjo nderhyrje pati efekt dhe nuk u ndoq nga Fed-i, gje qe nuk i dha mundesi dollarit te rimerte veten. Ne fillim te nentorit, Fed-i duke mos u pajtuar me kete prirje te dobesimit te dollarit, nderkohe qe te dhenat e ekonomise tregonin rritje, nderhyri perseri ne treg duke blere dollare kundrejt markes dhe jenit. Megjithate tregu mbeti skeptik dhe nuk shkoi me shume se 1,5260 marka, pasi kjo nderhyrje nuk u shoqerua nga bankat europiane. Ne mbledhjen e Nentorit te FOMC-se u vendos qe normat e interesit te rriteshin nga 4.75 ne 5.50 per qind, duke shkaktuar surprize ne treg. Fed-i e justifikoi kete hap me rritjen e shpejte te ekonomise, perdorimin e larte te kapaciteteve prodhuese dhe rrezikun e larte te inflacionit. Tregjet financiare e priten mire kete fakt dhe dollari arriti deri ne nivelin 1,58 marka dhe 100 jen. Deri ne fund te vitit keto monedha u treguan pak a shume ne keto nivele pasi nuk paten ndonje ndryshim te politikës monetare ne mbledhjen e fundit te vitit nga Fed-i si rezultat edhe i nje renie te aktiviteitit, karakteristike per kete periudhe.

Per vitin 1995 parashikimet jane shume te kujdesshme. Keshtu mendohet se deficiti i Llogarise Korrente ne 1994 do te jete faktori negativ baze per dollarin amerikan, ndersa ne favor do te jete diferenca e normave te interesit ndermjet dollarit ne raport me marken dhe jenin japonez. Keshtu, dollari parashikohet me mundesi te kufizuara ngjitjeje dhe niveli 1,65 marka, mendohet si kufiri me i larte, nderkohe qe ka mundesi qe prirja e renies se tij te ndaloje ne nivelet 1,40 / 1,43 marka.

Gjate vitit 1994, politika e kurseve te kembimit te Bankes se Shqiperise, si pjese perberese e politikës monetare te saj ka synuar qe te mbaje nje stabilitet ne kursin e kembimit pa synuar te ndikoje mbi prirjen e tij.

Ecuria e kursit te kembimit gjate vitit 1994 ndoqi te njejten llogjike si dhe gjate vitit 1993. Viti 1994 nisi me nje zhvleresim te lekut qe arriti maksimumin me 20 Janar 1994 ne nivelin 1 dollar=103.55 leke (shkaku kryesor ne kete rritje ishte mbyllja e ciklit te mallrave te shitura gjate Vitit te Ri, u rit kerkesa per valute). Pas kesaj, leku ruajti stabilitetin per nje periudhe katermujore (kursi i kembimit ne fillim te vitit ishte 1 dollare = 101.15 leke ne treg dhe 1 dollar=99.24 leke mesatarja ne Banke ndersa me date 31 Maj ishte 1 dollar=99.5 leke dhe 98.85 respektivisht) duke u luhatur ne intervalin +/- 1 per qind krahasuar me fillimin e vitit. Ky stabilitet i vendosur nuk vazhdoi pasi ekuilibri u prish ne favor te rivleresimit te lekut. Shkaqet qe cuan ne kete prishje ekuilibri ishin ndryshimet e raportit te eksportit me importin si dhe rritja e dergesave nga ana e refugjateve shqiptare ne Evrope.

Piken me te larte leku e arriti me date 13 Shtator ne nivelin 1 dollar=84 leke (vlere me e larte e lekut qysh nga koha e futjes se kursit fleksibel ne Sistemin Bankar). Gjate kesaj periudhe nje rol jo te vogel ne zbutjen e levizjeve te kursit te kembimit luajti edhe Banka e Shqiperise e cila nderhyri ne treg duke blere valute "cash" ne tregun paralel nepermjet sportelit te vet si dhe duke vazhduar blerjet ne llogari ne Sistemin Bankar. Tremujori i katert u karakterizua nga nje zhvleresim i lekut i cili mbylli vitin ne nivelin 1 dollare = 95.35 lek ne treg dhe 1 dollar=95.39 leke mesatarja ne Sistemin Bankar.

Ne rivleresimin e lekut ka ndikuar pozitivisht eshte rritja e besimit te njerezve ne qendrueshmerine e tij si dhe norma e interesit shume me terheqese se e valutave te tjera evropiane gje qe duket ne shifrat e meposhtme: Ne fillim te vitit depozitat pa afat ne leke ishin 10.242 milione, depozitave me afat ne leke ishin 11.705 milione dhe depozitat ne valute shprehur po ne leke 10.248 milione ndersa ne fund te Nentorit gjendja e po ketyre depozitave respektivisht ishte 9.063 milione leke, 18.022 milione leke dhe 13.123 milione leke.

Po te shohim kuotimet e tregut dhe mesataren e kursit te kembimit te dale nga kuotimet e Sistemit Bankar shohim se diferenca midis tyre ka ardhur duke u ngushtuar kjo per shkak se bankat tregtare jane bere me konkurruese duke ngushtuar speredin si dhe duke treguar me shume kujdes per pozicionet e tyre. Gjithashtu jo pak ne kete drejtim ka ndikuar dhe krijimi i nje pjesemaresi te ri ne treg "Zyrat e kembimeve valutore".

KAPITULLI VI AKTIVITETE TE TJERA

1. Administrimi i parase

Banka e Shqiperise ne cilesine e autoritetit te vetem monetar ka kopetenca dhe pergjigjet per emetimin dhe administrimin e monedhes se Shtetit Shqiptar. Gjate vitit 1994 Banka e Shqiperise ka emetuar 10.8 miliarde leke, emision ky rreth 3 miliarde leke me i larte se ai i vitit 1993. Ne fund te vitit 1994, monedha ne qarkullim figuron 28.4 miliarde leke, ose 57 per qind me e larte se nje vit me pare.

Paraja ne qarkullim sipas prerjeve

1992			1993			1994		
Prerja	numri	per qind	Prerja	numri	per qind	Prerja	numri	per qind
1	17,139	19.08	500	23,569	23.67	500	27,941	24.45
100	14,528	16.17	1	18,811	18.89	1	18,161	15.89
500	13,210	14.7	100	10,954	11.00	100	13,477	11.79
10	10,880	12.11	10	10,306	10.35	200	12,199	10.68
50	9,850	10.96	3	8,886	8.93	10	11,703	10.24
5	9,131	10.16	50	8,663	8.70	1000	9,796	8.57
3	8,669	9.65	5	7,397	7.43	3	7,720	6.76
25	5,400	6.01	200	6,369	6.42	5	7,463	6.53

1000	899	1.00	1000	3,788	3.80	50	5,404	4.73
10 l.v	105	0.12	25	775	0.78	25	409	0.36
50 l.v	36	0.04	10 l.v	10	0.01	10 l.v	1	0.00
200	0	0.00	50 l.v	2	0.00	50 l.v	1	0.00
Totali	89,847	100.00		99,557	100.00		114,275	100.00

E shprehur ne njesi fizike, gjate vitit 1994 jane emetuar 19.5 milione cope kartmonedha dhe 784 mije cope metalmonedha, ndersa jane hedhur ne qarkullim rreth 20 milione cope kartmonedha dhe 644 mije cope metalmonedha. Kartmonedhat e demtuara, ne fund te vitit ishin 33 per qind e kartmonedhave te perpunuara, perqindje relativisht e larte, por qe duke marre parasysh dhe ato qe ndodhen ne qarkullim mendohet te jete edhe me e larte. Ne mungese te nje kontrolli dhe perpunimi te automatizuar te kartmonedhave, eshte e kuptueshme qe kjo shifer te vazhdoje te jete te e larte.

Per keto arsye duhen bere investime ne automatizimin e kontrollit dhe te perpunimit te monedhave si dhe te specializimit te punonjesve qe do te merren me kete pune. Mirembajtja e monedhave eshte realizuar nepermjet emetimit dhe hedhjes ne qarkullim te monedhes se re si dhe nepermjet asgjesimit te atyre te vjeteruara nga perdorimi.

2. Sistemi i kontrollit te brendshem

Aktiviteti kryesor i Departamentit te Kontrollit ka qene analiza e procedurave operacionale dhe e problemeve specifike, funksionale ne departamentet e Bankes se Shqiperise.

Jane bere perpjekje per te institucionalizuar kontrollin duke pergatitur rregulloret dhe metodikat e tij. Sistemi i kontrollit te brendshem ka reduktuar riskun qe lidhet me cilesine e informacionit financiar. Gjate vitit 1994 u hartua nje plan i gjere per te kontrolluar zerat kryesore te bilancit te Bankes se Shqiperise si dhe efektivitetin e masave te sigurimit te marra per mbrojtjen e tyre.

Per ta bere sa me efikase zbatimin e politikës monetare, eshte kryer me efikasitet kontrolli i veprimtarise se rjetit te filialeve te Bankes se Shqiperise, duke mbuluar te gjitha filialet gjate ketij viti.

Kontrollet periodike per rakordimet e llogarive nderdegjore, sistemimit te veprimeve, percaktimi i riskut ne lidhje me sigurimin e parase, si dhe te asgjesimit te parave te demtuara kane ritur cilesine e punes se Bankes se Shqiperise

3. Administrimi i burimeve njerezore dhe kualifikimi

Strategjia per drejtimin e burimeve njerezore gjate vitit 1994, u perqendrua ne mobilizimin e personelit te bankes per zhvillimin me efektivitet te operacioneve bankare dhe ne rritjen graduale cilesore te saj. Baze e kesaj strategjie ishte njohja e gjendjes ne fund te vitit 1993 dhe percaktimi i mundesive te reja per vitin 1994 te tilla si, rritja e efektivitetit te veprimtarise, plotesimi ne kohe i objektivave si dhe permiresimi i proceseve te punes ne te gjithë sektoret.

Qe ne fillim duhet theksuar se aktiviteti per vitin 1994 pati dy drejtime kryesore :

- Bashkepunimi dhe kordinimi per politiken e personelit
- Drejtimi dhe organizimi i burimeve njerezore

Aktualisht struktura e personelit karakterizohet nga dy tipare: *e para*, eshte tendenca drejt funksioneve primare e kushtezuar nga numri i kufizuar i personelit i perfshire ne funksionet mbeshtetese dhe *e dyta*, rritja e shpejte gjate koheve te fundit e eksperiences se personelit.

Shperndarja e personelit gjate 1994, ne tre sektoret kryesore te Bankes Qendrore ishte si me poshte: *Funksionet primare* (politika monetare, ceshtjet e tregut financiar, dhe kontrolli i ofertes se parase) perfshinin rreth 60per qind te personelit, *funksionet mbeshtetese* (sherbimet e informacionit dhe te perpunimit te te dhenave) perfshinin rreth 10per qind te personelit, *funksionet e sherbimit* (sherbimet administrative dhe drejtimi) perfshinin rreth 30per qind te personelit.

Kjo shperndarje sherbeu si baze per vleresimin e punonjesve si dhe per studimin e politikës se pagave per te harmonizuar me mire raportet e percaktuara me pare midis drejtuesve dhe vartësve te tyre duke patur parasysh dhe ndryshimet strukturore qe parashikoheshin te beheshin kete vit ne organizimin e drejtorive.

Nje nder arrijet me te rendesishme ishte komunikimi i pergjithshem dhe trajnimi. Ne fushen e kualifikimit rendesi e madhe iu kushtua edhe rritjes se efektivitetit te punes se Qendres se Trainingut te Bankiereve. Per here te pare, kjo qender zhvilloi programet e kualifikimit pasuniversitar per punonjes te ndryshem te Sistemit Bankar Shqiptar.

Ne strategjine e saj afatmesme Banka e Shqiperise do te ballafaqohet me dy probleme te rendesishme: *Se pari*, ceshtje e rendesishme eshte rritja absolute e numrit te personelit te Bankes se Shqiperise. Eshte e qarte, se numri aktual nuk eshte i pershtatshem per vitet qe do te vijne (te pakten do te duhet nje dyfishim i stafit ne 5 vitet e ardhshme). Megjithate, vemendja kryesore do te perqendrohet mbi cilesine

e burimeve njerezore. etj. *Se dyti*, ndryshimi i perberjes se struktures se personelit. Funkcionet mbeshtetese jane relativisht te uleta (synohet te zene rreth 15per qind te personelit) dhe nga ana tjeter si rezultat i automatizimit te ulet, funksionet paresore zene nje numer shume te madh. Arritja e ketyre dy objektive do te kerkoje rritjen e transparences ne procedurat e punesimit, nxitjen e motivimit per pune, trainimin intensiv te personelit, etj.

Padyshim rritja e motivimit per punen do te sigurohet nepermjet nje politike pagash me efikase. Ne strategjine afatmesme, me konsolidimin e metejshem te sektorit financiar, pafuqishmeria e Bankes se Shqiperise per te konkuruar me pagat e ofruara nga bankat tregtare do te perbeje nje problem shume serioz, vecanerisht per specialistet e fushave te tilla si kembimet valutore, mbikqyrja bankare, informatika, etj.

Nga ana tjeter, Banka e Shqiperise do te krijojte nje sistem me te pershtatshem per vleresimin e arritjeve te cdo punonjesi.

4. Zhvillimet ne Sistemin e Pagesave

Modernizimi i sistemit te pagesave ne Shqiperi, si nje nga elementet e rendesishem ne progresin e sistemit bankar, ka synuar ne permiresimin e efikasitetit, uljen e koston dhe permiresimin e ndermjetesimit bankar.

Ne muajt e pare te vitit, me miratimin ne Parlament te amendamenteve perkatese per Ligjin "Mbi Cekun" u plotesua kuadri ligjor i nevojshem per funksionimin normal te sistemit te cekut dhe te kleringhausit. Ne te njejten kohe, kjo periudhe perkon me nje trainim intesiv te personelit qe punon prane ketij sektori si dhe te punonjesve te bankave te nivelit te dyte.

Perpunimi, diskutimi dhe miratimi i rregullave te kleringhausit per sigurimin e kushteve mbeshtetese per shkembimet dhe rregullimet neper llogarite perkatese si dhe per te drejtat e detyrat e pjesemarresve, ndikuan ne rritjen e cilsise se sherbimeve bankare.

Nga mesi i vitit te kaluar filloi perdorimi i cekut nga bankat e nivelit te dyte per terheqjet e parave nga llogarite e tyre neper filialet e Bankes se Shqiperise. Sidoqofte futja e cekut si forme pagese, ndonese nuk eshte e re dhe pak e njohur ne sistemin bankar, nuk po gjen shtrirjen e synuar nga Banka e Shqiperise pasi

ketu ndikojne nje sere faktoresh te tille si periudha tranzitore e ndryshimit te sistemit e lidhur ngushte me trashegimine profesionale bankare, mekanizimi, menyra e konkureses si rezultat i ekzistences vetem te sektorit shteteror te ketij sistemi. Per pasoje sherbimi ndaj klienteles nuk i pergjigjet kerkesave.

Ne strategjine afatshkurter te Bankes se Shqiperise, objektivat prioritare per te ardhmen do te permbledheshin ne:

Se pari, ceshtja e percaktimit te nje strategjie per sigurimin e nje radhe sherbimesh te sistemit te pagesave ndaj institucioneve financiare.

Se dyti, per te ardhmen do te synohet te permiresohet ndjeshem sistemi i pagesave dhe ne vecanti perdorimi i çeqeve si nje zgjidhje praktike e domosdoshme ne shkembimet e vlerave midis individeve, atyre dhe bankave si dhe vete bankave.

Se treti, permiresimi i sherbimeve te bankare te nivelit te dyte me qellim qe ajo te afrohet me shume prane klienteles.

Se katerti, futja e perdorimit te cekut per kryerjen e transaksioneve qeveritare. Pagimi i faturave per agjencite e ndryshme dhe pranimi i cekut ne pagimin e taksave do te ishte nje permiresim shume i dukshem ne sherbimet publike.

5. Botimet periodike te Bankes se Shqiperise

Veprimtaria e Bankes se Shqiperise, ne fushen e politikës monetare te ndjekur nga ajo, ne ristrukturimin e sistemit bankar si dhe detyra te tjera te saj jane pasqyruar ne menyre te gjere dhe te plote ne botimet periodike te saj.

Ne Raportin Vjetor te Bankes se Shqiperise, i cili u botua per hartua per here te pare per vitin 1992, jane pasqyruar zhvillimet ne ekonomine kombetare, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqiperise ne fushen e kreditimit te ekonomise dhe te buxhetit te shtetit, ne fushen e zhvillimeve monetare dhe likuiditeteve ne ekonomi qe lidhen me kete politike kredituese, ne politiken e nivelit te interesave, etj. Nje vend te vecante ka zene ristrukturimi i sistemit bankar si nje kusht i rëndesishem per zhvillimin me sukses te tij. Pasqyrim te vecante per rëndesine e tij, ka zene bilanci i pagesave. Keto raporte po ashtu, jane shoqeruar me anekse te pasura statistikore qe perfshijne te dhena te nje periudhe mjaft te gjere dhe nepermjet te cilave mund te krijohet nje tablo e qarte e zhvillimeve makroekonomike te vendit si dhe zhvillimeve monetare qe lidhen me to.

Ne funksion te informimit dhe te pasqyrimet me koherent te veprimtarise se Bankes se Shqiperise ka ndikuar edhe botimi i Revistes Bankare numri i pare i se ciles doli me 1 mars 1994. Tematika e kesaj reviste ka qene e larmishme dhe gjate kohes ajo eshte permiresuar si ne permbajtje ashtu edhe ne menyren e paraqitjes se saj.

Si rrjedhoje e organizimit te vazhdueshem te te gjitha sistemit bankar ne Shqiperi, per te pasqyruar me mire funksionet e Banka e Shqiperise ne drejtimin e sistemit bankar dhe rolin e saj ne sektorin financiar si dhe per te rritur nivelin e informacioneve per te gjitha subjektet e interesuara eshte i nevojshem nje ristrukturim i permbajtjes se saj. Rubrikat e reja qe mund te levrohen mendohet te jene: 1.Opinione, ne te cilen do te merren mendime rreth reformes ekonomike ne pergjithesi dhe te sistemit bankar ne vecanti nga specialiste, ekonomiste, biznesmen, vendas ose te huaj. Rubrika mendohet te ndertohet ne forme debati per te ballafaquar opinionet e ndryshme per te patur nje zgjidhje sa me optimale. 2.Profile , qe do ti kushtohet personaliteteve te ndryshem vendas ose te huaj, ne fushat e ndryshme te ekonomise, pasqyra e zhvillimit ekonomik te vendeve te ndryshme etj. 3.Shkurt nga bota, ne te cilen do te jepen fakte dhe ngjarje nga me fundit ne boten e financave, biznesit, kapitaleve etj. Po keshtu mendohet te kete edhe disa rubrika si intervista; tregjet gjate nje muaji; kalendar; fjalor ekonomik etj.

Po ashtu, Banka e Shqiperise boton Raportin Statistikor si dhe Raportin Monitorues. Te dyja keto botime jane periodike, mujore. Ne Raportin Statistikor gjen pasqyrim ne forme statistikash veprimtaria dhe treguesit financiar, zhvillimet monetare, zhvillimet e ekonomise monetare etj. Ky botim i drejtohet nje rrethi te gjere specialistesh ne fushen e ekonomise, te financave, te biznesit etj.

Ne Raportin Monitorues ndiqen me vemendje zhvillimet ekonomike dhe monetare ne ekonomine nderkombetare si dhe lidhja e ndikimi i tyre ne proceset e zhvillimeve ekonomike ne vendin tone. Keto lidhje dhe ndikime analizohen ne shume aspekte qe nga treguesit makroekonomike, mikroekonomike e deri tek niveli i interesave dhe kurset e kembimit. Analiza me e thelluar e ketyre lidhjeve do te jete nje nga objektivat e punes se sektoreve te Departamentit te Politikes Monetare ne te ardhmen, pas ristrukturimit te fundit te tij.

6. Marrredheniet me Institucionet Financiare Nderkombetare

Perparimi i arritur gjate vitit 1994 nga Banka e Shqiperise ne rruget e saj te shnderrimit ne nje Banke Qendrore moderne eshte pasqyruar edhe ne zhvillimin dhe intensifikimin e metejshe me marrredhenieve me Institucionet Financiare Nderkombetare.

Keshtu pas perfundimit te programit mbeshletes "STAND-BY" me FMN-ne, filloj te zbatohet programi ESAF. Kesti i pare u akordua ne korrik 1993 per 8,47 milion SDR i cili u pasua edhe nga dy keste te tjera te saj respektivisht ne prill dhe tetor 1994 per 8,47 dhe 7,06 milion SDR. Kredia e marre per programin ESAF, mbeshtet programin afatmesem te rregullimit makroekonomik dhe strukturor per peiudhen 1993-1996.

Nga Banka Boterore ka vazhduar mbeshetja me programin EFSAC per reformen e ristrukturimit dhe modernizimit te Sistemit Bankar ne Shqiperi. Ky program po ashtu perfshin periudhen 1993-1996. Keto reforma lidhen me zhvillimin e kuadrit ligjor per Sistemin Bankar, duke perfshire kerkesat e zhvillimit te funksioneve te Bankes Qendrore si instrumentat indirekte te politikës monetare, te administrimit te kredise, mbikqyrjen bankare. Po keshtu ajo do te ndihmoje ne zhvillimin e tregut te letrave me vlere, zhvillimin e bankave tregtare nepermjet hartimit dhe zbatimit te nje sistemi te permiresuar pagesash, futjes se nje sistemi te ri te drejtimit dhe administrimit te bankave si dhe te permiresimit te sherbimit postar bankar, i cili filloj funksionimin e plote gjate tremujorit te dyte 1994 duke mbuluar qytetet kryesore te vendit.

Megjithë insistimin e Komunitetit Evropian gjate 1994 per shkak te vetos greke nuk u be i mundur akordimi i nje shumeprej 35 milion ECU per Shqiperine, e cila do te jepej ne mbeshetje te Bilancit te Pagesave dhe per forcimin e rezervave te vendit.

Per vitin 1994, Banka e Shqiperise ka perfituar asistence teknike nga Institucionet Financiare Nderkombetare, si nga FMN-ja, Banka Boterore, UNDP-ja dhe EC PHARE etj. ashtu edhe nga bankat qendrore te vendeve te tjera. Asistenca teknike qe eshte ofruar i ka sherbyer organizimit te te dhenave dhe raportimit te tyre ne perputhje me kerkesat e programit monetar si dhe te zbatimit te instrumentave te mundshem te politikës monetare te Bankes se Shqiperise. Po keshtu ne asistencen e FMN-se u hartuan projektet e krijimit te nje sistemi informativ ekonomik dhe te kontrollit te administrimit te likuiditeteve ne treg.

Gjate ketij viti ndihma teknike ka ardhur duke u specifikuar edhe me shume dhe keshtu ka ndihmuar ne zbatimet dhe ne futjen e kuptimeve te reja qe jane zhvilluar ose saktësuar gjate kohes. Asistenca teknike ka prekur fusha te tilla si Programimi Financiar, Politikat Makroekonomike dhe Financiare, etj. Asistenca teknike afatgjate ka vazhduar edhe nepermjet keshilltareve rezident qe kane mbuluar operacionet monetare, ankandet e bonove te thesarit, zhvillimin e procedurave te kontabilitetit, sistemin e pagesave, sistemin monitorues te rezerves valutore, etj.

Po ashtu FED e New Yorkut ka ndihmuar per permiresimin e legjislacionit, FED e Bostonit per sistemin korier dhe sigurimin, Banka e Finlandes per informatizimin drejtimin dhe organizimin. Banka Qendrore e Austrise, Finlandes, Gjermanise, Italise, Frances dhe Anglise morren persiper kualifikimin afatshkurter te punonjesve te bankes tone. Vlen te përmendet edhe BIS Basel per koordinimin e asistences teknike ndermjet vendeve donatore dhe atyre perfituese.

7. Informatizimi ne Sistemin Bankar

Transformimet cilesore te ekonomise shqiptare nuk mund te kuptohen pa nje shnderim te plote te Sistemit Bankar. Ne kete aspekt, sot funksionimi i nje banke, nuk mund te kuptohet pa nje rrjet kompjuterik, i cili mundeson perpunimin dhe analizen e te dhenave me efikasitet te larte.

Objektivi kryesor i vitit 1994 ka qene projektimi i rrjetit informatik, per vete faktin, se volumi ditor i te dhenave, kompjuterizimi i operacioneve kontabel dhe analizat e hollesishme, e diktojne ate si nje domosdoshmeri imediate. Me kete synim Banka e Shqiperise e zgjeroi dhe e konsolidoi edhe me teper kompjuterizimin e anes operacionale ne tere veprimtarine e saj.

Edhe bankat e nivelit te dyte, gjate ketij viti bene hapa relativisht te suksesshme ne drejtim te kompjuterizimit te operacioneve kontabel, hapa te cilat me siguri do te konsolidohen gjate vitit 1995.

Por duhet thene se situata aktuale e kompjuterizimit te Sistemit Bankar ne Shqiperi nuk ka aritur ende ne nivelin e kerkesave te kohes, keshtu qe, pikesynimi kryesor mbetet ndertimi i rrjetit informatik i bankes si dhe kalimi ne nje baze te re te dhenash.